

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 E mërkurë, 20 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes. Dhe mirë se erdhët.

7 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Mirëmëngjes.

13 Së pari, do të doja t'ju kërkoja që të prezantonit,
14 paraqisnit kush është i pranishëm sot në sallën e gjyqit duke
15 filluar nga ZPS-ja.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar
17 Gjykatëse. Nga ZPS-ja është Line Pedersen, Federica Genovesi,
18 Cesary Michalczuk, Gaia Pergolo dhe unë jam Filippo de
19 Minicis.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Mbrojtësi i Viktimave.

22 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Jam
23 Simon Laws, Përfaqësuesi i Viktimave për këtë çështje
24 gjyqësore së bashku me bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Mbrojtja e të akuzuarit.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi, e nderuar
3 Gjykatëse. Unë jam z. Gilissen. Jam së bashku me z. Aouini dhe
4 znj. Cariolou. Jemi së bashku edhe me pjesën tjetër të ekipit
5 që është Kailin Chen, oficere ligjore; znj. Juliette Healy dhe
6 Judit Kolbe, asistente përgjegjëse për rishikimin e provave
7 materiale; Alana Goncalves që është stazhiere e re, Livia
8 Veliu, që është menaxhere e çështjes që është nga Shqipëria
9 dhe Dzeneta Petravica. Dhe sigurisht z. Shala që na ndjek
10 përmes videolidhjes.

11 Z. Shala, a e konfirmoni që e dëgjoni mirë përkthimin?

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

13 Mirëmëngjes, ju ndëgjoj shumë mirë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot
15 do të fillojmë me prezantimin e provave nga Mbrojtja. Do të
16 dëgjojmë dëshminë e dëshmitarit të parë Mbrojtjes z. Bardhyl
17 Mahmuti.

18 Përpara sesa të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit, Trupi
19 Gjykues dëshiron që të trajtojë disa çështje procedurale, duke
20 përfshirë, Avokati i Mbrojtjes, edhe postën, mesazhin
21 elektronik që kemi marrë sot në mëngjes që ka të bëjë me
22 dokumentin që ZPS-ja synon që të përdorë në marrjen në pyetje
23 të këtij dëshmitari sot ose nesër. Do ta trajtojmë edhe këtë
24 çështje.

25 Disa prej çështjeve procedurale që do të diskutojmë tani,

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 janë çështje të njohura ose pjesërisht të njohura për palët
2 dhe për Mbrojtësin e Viktimave sepse për arsye të zhvillimit
3 të procesit gjyqësor ka pasur shkëmbime mesazhesh elektronike,
4 korrespondence me postë elektronike ndërmjet palëve dhe është
5 e rëndësishme që ta themi këtë për procesverbal për ta bërë të
6 gjurmueshme.

7 Atëherë grupi i parë i çështjeve ka të bëjë me paraqitjen
8 e provave nga Mbrojtja dhe planifikimin e dëshmitarëve të
9 Mbrojtjes.

10 Së pari, Trupi Gjykses do vendos për procesverbal një
11 urdhër që i ka dhënë Mbrojtjes përmes postës elektronike më
12 datë 1 shtator.

13 Në mënyrë që të sigurohej që marrja në pyetje e
14 dëshmitarëve të realizohet në mënyrë efikase dhe të jetë e
15 përqendruar për nxjerrjen e provave që janë të rëndësishme për
16 këtë lëndë gjyqësore, Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen për ta
17 shkurtuar zgjatjen e vlerësuar për marrjen në pyetje të
18 dëshmitarëve të caktuar si vijojnë:

19 Për dëshmitarët 01, domethënë, Dëshmitari i Mbrojtjes 01,
20 për çështjen 4, Dëshmitari 02, Dëshmitari 05, 06 dhe
21 Dëshmitari 4754, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen ta shkurtojë
22 kohëzgjatjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga katër orë
23 në tre orë. Ndërsa për Dëshmitarin 3887, nga tetë orë në katër
24 orë.

25 Për pasojë, Trupi Gjykses ka rishikuar gjithashtu kohën e

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 përgjithshme që i është caktuar Mbrojtjes për paraqitjen e
2 lëndës së saj dhe vendos që Mbrojtja të ketë 31.5 orë
3 gjithsej. Sigurisht, që kjo nuk cenon asnjë kërkesë që mund të
4 bëhet sipas rregullave 153 të Rregullores që është një rregull
5 që është përdorur në një prej kërkesave të bëra nga Mbrojtja
6 dhe sigurisht në qoftë se është e nevojshme do të japim më
7 tepër kohë për dëshmitarë të caktuar.

8 Këtu përfundon urdhri i parë me gojë.

9 Së dyti, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja po punon akoma
10 për konfirmimin e datave ekzakte, pra, datave të sakta për
11 disa [prej] dëshmitarëve. Kjo paraqitet në parashtrimin e
12 protokolluar 634. Në këtë pikë, ju bëjmë thirrje që të
13 planifikoni dëshmitarët në mënyrë të njëpasnjëshme, në mënyrë
14 konsektive. Ne dua që të shmangim, le të themi, ato hapësirat
15 ndërmjet dëshmitarëve në mënyrë të tillë që të përdorim të
16 gjithë kohën që na është caktuar për sa i takon Gjykatës, pra,
17 kohën së përdorimit të Gjykatës. Do t'ju them edhe më vonë që
18 ju udhëzojmë që të filloni me marrjen në pyetje të Dëshmitarit
19 4754 që është planifikuar që të dëshmojë gjatë bllokut të tetë
20 provues, të hënën, më 23 tetor. Atëherë ne kemi tri ditë 23,
21 24, 25, kështu që le të fillojmë që më datë 23. Dhe kjo do të
22 na ndihmonte që ta përdornim në mënyrë efiçente sallën e
23 gjyqit.

24 Nëse del e nevojshme që për këtë dëshmitar të dëshmojë
25 përmes videolidhjes edhe pse kemi thënë edhe kemi vënë e kemi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 5

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 nënvijëzuar preferencën apo parapëlqimin e Mbrojtjes për të
2 qenë i pranishëm dëshmitari në sallën e gjyqit, Trupi Gjykues
3 e drejton Mbrojtjen që të bëjë kërkesën e përshtatshme në
4 kohën e duhur. Në mënyrë të tillë që të kemi kohë të nevojshme
5 për të bërë të gjithë organizimet për videokonferencën, por,
6 gjithsesi, ky udhëzim do të jepet vetëm nëse vendoset që
7 dëshmitari të japë dëshmi përmes videolidhjes.

8 Udhëzimi i tretë, ka të bëjë me kërkesën tuaj për të
9 ndryshuar listën e provave materiale. E kam fjalën pikërisht
10 për parashtrim e protokolluar 649 datë 12 shtator 2023. Ju
11 kërkoni leje për të shtuar shtatë materiale të cilat lidhen me
12 Dëshmitarin 6, 3, dhe Dëshmitarin 3887.

13 Ne e udhëzuam ZPS-në, Mbrojtjen e Viktimave përmes postës
14 elektronike, të datës 14 shtator, që t'i përgjigjet kërkesës
15 së Mbrojtjes dhe ata, nëse dëshirojnë, mund të përgjigjen dhe
16 me gojë këtu përpara Trupit Gjykues.

17 Kështu, z. Prokuror ose znj. Prokurore, nuk e di në qoftë
18 se doni që të përgjigjeni kësaj kërkesë të Mbrojtjes.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim për të.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Mbrojtësi i Viktimave?

22 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, as ne nuk e kundërshtojmë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

24 rregull.

25 Ne jemi bindur që kërkesa është dorëzuar në kohën e duhur

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 dhe mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë dëshmitë e
2 dëshmitarëve dhe po ashtu vërejmë që nuk ka kundërshtim nga
3 palët për këtë kërkesë.

4 Kështu që si rezultat neve e miratojmë këtë kërkesë në
5 përputhje me rregullin 119(5) të Rregullores. Dhe gjithashtu
6 ju kërkojmë që të përditësoni listën tuaj të provave materiale
7 deri të martën, në datë 26 shtator 2023.

8 Këtu përfundon urdhri i dytë gojor i Trupit Gjykses.

9 Tani, dua që të trajtoj kërkesën e Mbrojtjes në
10 parashtrimin e protokolluar 658, që jep informacion shtesë për
11 Dëshmitarin 01, për të cilën ne morëm njoftim dje, për këtë
12 pikë dua që të kalojmë në seancë private.

13 Znj. Sekretare, të lutem na kaloni në seancë private.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë private)

Faqe 7

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 jemi në seancë publike.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, znj. Sekretare.

20 Duhet të bëjmë një korigjim për transkriptin. Korigjimi
21 është në faqen 4, në rreshtin 15. Ne kemi regjistruar që unë
22 thashë Dëshmitari 4, por, në fakt, duhet të jetë Dëshmitari 6.
23 Sepse bëra një gabim të vogël, një lapsus të vogël.

24 Atëherë do të kalojmë tek pika e pestë. Dua që të flas
25 tani për njoftimin e Mbrojtjes për dëshmitarët ekspertë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 9

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Mbrojtjes së Viktimave. E kam fjalën për parashtrimin e
2 protokolluar 653 të datës 15 shtator 2023. Në parashtrimet
3 tuaja Mbrojtje, ju kundërshtoni pranimin e aktekspertizës të
4 Stefan Lerz si dhe shprehni dëshirën për të marrë në pyetje
5 këtë dëshmitar. Po ashtu, ju thoni se refuzoni të drejtën tuaj
6 për të përcaktuar qëndrimin tuaj të hollësishëm si edhe
7 pyetjet që dëshironi t'i bëni dëshmitarit ekspert në kohën e
8 duhur.

9 Fillimisht Trupi Gjykses kujton se kemi bërë një
10 konstatim se zhdëmtimet apo sukseset zhdëmtuese, do të kryhen
11 si rregull i përgjithshëm me shkrim në pajtim me rregullin 168
12 të Rregullores. Ky është parashtrimi i protokolluar 598 datë
13 21 korrik 2023. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses e urdhëroi
14 Mbrojtjen që të paraqiste pyetjet e dëshirueshme me shkrim të
15 cilat do t'i transmetohen dëshmitarit ekspert, i cili nga ana
16 e tij do të japë do të jap gjithashtu një përgjigje me shkrim.
17 Pra, kjo është procedura të cilën ne kemi përcaktuar. Ne do
18 t'i qëndrojmë udhëzimeve të dhëna më herët dhe nuk synojmë që
19 të kemi dëshmitarin të vijë të japë dëshmi në Gjykatë, në
20 përjashtim të rasteve kur ju do të na jepni arsye bindëse për
21 të bërë një gjë të ndryshme.

22 Thënë kjo, dua të ngre dhe një çështje tjetër. E vërejmë
23 që ju kërkon kohë shtesë për ekspertin për të vlerësuar
24 raportin e z. Lerz dhe rezervoni të drejtën tuaj për të
25 përcaktuar pozicionin ose qëndrimin e tij të detajuar si dhe

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 pyetjet që dëshironi që t'i bëni atij.

2 Sa i takon këtyre parashtrimeve, Avokat Mbrojtës, ne
3 vërejmë që ju nuk keni respektuar afatin e përcaktuar nga
4 Trupi Gjykues dhe gjithashtu nuk bëtë një kërkesë të duhur për
5 zgjatjen e afateve. Sigurish që nuk më duhet që t'ju kujtoj
6 dhe mbase mund të duket pak e ashpër nga ana ime, por nuk më
7 duhet mua t'ju kujtoj sesi është formuluar dhe çfarë
8 parashikon kodi i sjelljes në këtë aspekt. Kështu që për herën
9 tjetër, do ju kërkoja që të bënit një kërkesë të duhur për
10 zgjatjen e afateve, në qoftë se jeni në një situatë të tillë.
11 Dhe në bazën e asaj, ne do të marrim një vendim. Ju e keni
12 bërë këtë gjë më herët dhe, mendoj, që kjo është mënyra më e
13 mirë për të vijuar në të ardhmen.

14 Megjithatë, Avokat, a mund të na thoni se kur e vlerësoni
15 që të keni mundësi që të identifikoni pyetjet?

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Së pari më lejoni të them që nuk
17 është pyetja jonë, e nderuar Gjykatëse.

18 Ne kemi gjetur një eksperte të vërtetë nga Kosova që
19 është në gjendje që të punojë me ne. Dhe, sipas mendimit tim,
20 puna do të bëhet mirë brenda tre javëve ose maksimumi një
21 muaj, sepse ekspertja tashmë ka të gjitha dokumentet e
22 nevojshme, po i studion të gjitha dokumentet e nevojshme dhe
23 po presim që ajo të dorëzojë raportin e parë. Ju kërkoj ndjesë
24 për vonesën. Ka qenë një kohë e gjatë pritjeje, por tani nuk
25 do presim dhe shumë.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull. Po kërkesa sa i takon mënyrës sesi do të punohet për
3 të ardhmen?

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj që ne bëjmë më të mirën
5 tonë të mundshme, po shumë herë nuk ja dalim, por mendoj që
6 është më mirë.

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Më lejoni të shtoj diçka.

8 Jemi përpjekur që ta njoftojmë Trupin Gjykes në kohën
9 kur kemi marrë dokumentet që ne po përpigemi që të kontaktojmë
10 me një ekspert për të na dhënë mendimin e vet.

11 Por qëndrimi i Mbrojtjes ishte që së pari të sigurohej
12 për kohën që i duhej ekspertit dhe pastaj të bënim një kërkesë
13 përpara Trupit Gjykes. Pra, së pari, t'i jepnim mundësi
14 ekspertit që të shikonte raporte, të shikonte dokumentet dhe
15 pastaj të bënim kërkesën tonë.

16 Për shkak të faktit që nuk kishim një kohë të dhënë nga
17 ekspertja, atëherë nuk mund ta shkruanim dot kërkesën sepse
18 nuk e dinim se sa kohë do të duhej, nuk dinim sesa kohë do të
19 donim të kërkonim për shtyrje afati. Ne i kemi bërë të gjithë
20 hapat e mundshme. Së pari, u nënshkruan dokumentet e
21 konfidencialitetit pastaj i dhamë të gjithë dokumentet
22 materialet e nevojshme që i duhen ekspertit. Dhe në momentin e
23 parë që të kemi një ide më të saktë për sa kohë i duhet
24 ekspertit për raportin, atëherë do të bëjmë kërkesën dhe,
25 sigurisht, që është në dorën tuaj të nderuar Gjykatës që ta

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 miratoni kërkesën tonë apo ta trajtoni atë ndryshe.

2 Pra, do këtë dy gjëra: Pyetjet e mundshme që mund t'i
3 bëjmë ekspertit të viktimave mbështetur në opinionin e
4 ekspertit tonë, ndërkohë që një çështje tjetër që mund të
5 marrë pak më tepër kohë është që në qoftë se është e
6 zbatueshme të marrim një raport me shkrim nga eksperti ynë dhe
7 më pas ta ngarkojmë këtë raport si një prej dokumenteve në
8 listën e provave materiale, siç e kemi bërë edhe me dëshmitarë
9 të tjerë.

10 Pra, ne nuk dëshironim të bënim një kërkesë që nuk kishte
11 kohë, ishte e hapur në kohë, domethënë, nuk dinim se ç'a t'ju
12 kërkonim sa i takon shtyrjes së afatit. Ne besojmë që e kemi
13 njoftuar mjaftueshëm Trupin Gjykses dhe palët që po kërkojmë
14 konkretisht këshillim për këtë provë ekstra, provë tejet
15 specifike që ka dhënë viktima por sikurse e thashë nuk kishim
16 një vlerësim kohe dhe për këtë arsye ishte e pamundur për ne
17 për të bërë kërkesën.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, Avokat.

20 Megjithatë për herë tjetër do ju udhëzoja që në qoftë se
21 ne përcaktojmë një afat, ju duhet të na drejtoheni, të thoni
22 që doni një shtyrje kohe. Edhe në qoftë se na thoni nëse do ta
23 ngrini këtë çështje në Gjykatë edhe kjo mjafton. Megjithatë
24 gjuha, formulimi që u përdor tani ishte shumë i hapur dhe që
25 nuk ishte në përputhje me afatet që ne kishim dhënë dhe ky

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 ishte aspekti që doja të ngrija.

2 Tani sa i takon mënyrës sesi do të procedojmë, si do të
3 vazhdojmë. Ajo çka do të bëjmë tani është që unë do të jap një
4 urdhër me gojë lidhur me atë se çfarë do të bëjmë në javët në
5 vijim lidhur me formulimin e pyetjeve. Do të miratojmë zgjatje
6 të afatit me tre javë, në mënyrë të tillë që të përgatiten
7 pyetjet për t'ia paraqitur z. Lerz me shkrim dhe kjo është,
8 domethënë, më 11 tetor 2023 pyetjet duhet të dorëzohen.

9 Dhe pastaj Mbrojtësi i Viktimave është përgjegjës për
10 dorëzimin e përgjigjeve të z. Lerz brenda tre javëve pasi merr
11 pyetjet nga Mbrojtja.

12 E shikoj që u ngritët në këmbë, Avokat i Viktimave. Pra,
13 më lejoni së pari që të përfundoj me urdhrin dhe pastaj do ju
14 jap fjalën për ndërhyrjen tuaj.

15 Po ashtu Mbrojtja e të akuzuarit ju urdhërojmë që t'i
16 nxirrni Trupit Gjykues emrin dhe kualifikimet e ekspertëve
17 tuaj dëshmitarë sepse, aktualisht, nuk jemi të informuar se
18 kush është ky dëshmitar, se keni një dëshmitar ekspert.

19 Kur do keni mundësi që të jepni këtë informacion?

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Sa më shpejt të jetë e
21 mundur.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Atëhere deri në fund të këtij muaji duhet ta kemi emrin.

24 Përpara sesa të vijojmë më tej dua t'i jap fjalën
25 Mbrojtësi i Viktimave.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. LAWS: [Përkthim] Po ngrihem në këmbë për mirësjellje,
2 sepse mu drejtuat mua, atëherë sa i takon çështjes së
3 pyetjeve.

4 Sigurisht, që ne kemi informuar Dr. Lerz që do t'i marrë
5 pyetjet diku nga 15 shtatori dhe tani do t'i themi që pyetjet
6 di të dërgohen më datë 11 tetor. Në qoftë se ka ndonjë
7 vështirësi që do ju transmetojë zotëria, atëherë do t'jua
8 bëjmë këtë me dije juve, të nderuar Gjykatës.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.

11 Atëherë, së fundi, Mbrojtja udhëzohet të informojë
12 ekspertin dëshmitar të rezervojë një ditë në periudhën e kohës
13 nga 20 nëntori dhe 1 dhjetori, si edhe në javën e parë pas
14 pushimit të dimrit të Gjykatës për të siguruar
15 disponueshmërinë e tij, në qoftë se do të vendoset që të
16 thërritet përpara Trupit Gjykses.

17 Dua ta bëj të qartë që ky është parimi në përgjithësi i
18 Trupit Gjykses, megjithatë dua të theksoj që i njëjti udhëzim
19 zbatohet gjithashtu edhe për Mbrojtësin e Viktimave.

20 Ne i kërkojmë Mbrojtësin e Viktimave që ta informojë z.
21 Lerz sa i takon të njëjtave ditë që thashë më herët.

22 Sa i takon Mbrojtjes dhe Mbrojtësi i Viktimave ju
23 kërkojmë atyre që të ndërliohen me njëri-tjetrin në mënyrë të
24 tillë që të mos kërkojnë të njëjtat data për dëshmitarët se
25 pastaj i takon që të kemi një lloj përplasje dëshmitarësh në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 15

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 qoftë se ju kërkoni që t'i dëgjojmë ata të dy brenda të
2 njëjtave ditë, po do ju kërkohet që ju të keni diskutime *inter*
3 *partes* lidhur me këtë.

4 Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, dua të bëj
5 një sqarim për procesverbal.

6 A duhet ta kuptojmë që përgjigja nga z. Lerz që do të na
7 jepet përmes Mbrojtësit të Viktimave do të na jepet më datën 1
8 nëntor? Që është tre javë pas 11 tetorit? Kështu i takon?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
10 tre javë kështu i takon. Kjo është ideja. Dhe në qoftë se
11 është e nevojshme si dhe në varësi të dëshmitarëve të tjerë që
12 do të thërriten në Gjykatë për të dhënë dëshmi në atë bllok
13 provues ose në atë kohë Gjykate, pra, do të duhet që të
14 shikojmë dhe neve në qoftë se është e mundur që vërtetë të
15 jetë kjo data e saktë. Na duhet të shikojmë pak planifikimin
16 për të siguruar që bëhet fjalë për të njëjtën datë vërtetë.

17 Kjo përfundon urdhrin e tretë gojor të Trupit Gjykses.

18 Çështja e gjashtë ka të bëjë me dokumentet ose materialet
19 që Mbrojtja synon që të përdorë gjatë marrjes në pyetje të
20 dëshmitarit të ditës së sotme, që është Dëshmitari 6.

21 Mbrojtja kërkon që të përdorë ndërmjet dokumenteve të
22 tjera edhe materialin DPS01524 deri në DPS01547, së bashku me
23 versionin në serbisht të këtij dokumenti, si dhe materialet
24 DPS00270-DPS00863.

25 ZPS-ja kundërshton përdorim e dokumenteve në fjalë për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Page 16

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 mungesë rëndësie ose lidhje me çështjen.

2 Në mënyrë që të bëhet përdorim efikas i kohës së
3 disponueshme për Trupin Gjykses, Trupi Gjykses ka marrë
4 parashtrime nga palët për këtë çështje përmes postës
5 elektronike dhe tani do jap një urdhër me gojë.

6 Trupi Gjykses nuk do të lejojë për momentin, aktualisht,
7 pra, që Mbrojtja t'i përdorë këto dy dokumente gjatë marrjes
8 në pyetje të dëshmitarit sepse Mbrojtja nuk ka përcaktuar, nuk
9 ka vërtetuar lidhjen e këtyre dokumenteve me akuzat e ngritura
10 kundër të akuzuarit.

11 Tani na duhet të kalojmë në seancë private.

12 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

13 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
14 bazë të F744

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 jemi në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit, znj. Sekretare.

19 Tani jemi në seancë private sepse kjo pjesë lidhet me
20 udhëzimet dhe pyetje të mundshme që mund t'i bëni dëshmitarit
21 dhe mendoj se është më mirë që këto çështje, këto aspekte t'i
22 trajtojmë në seancë private duke marrë parasysh edhe këtë
23 dëshmitar dhe dëshmitarë të tjerë në të ardhmen.

24 Mbrojtja mund të eksplorojë çdo teori të lëndës gjyqësore
25 me dëshmitarët e vetë por këto teori duhet të lidhen me rastin
apo me çështjen konkrete që ka marrë Trupi Gjykses dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 17

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Mbrojtja duhet të vërtetohet një lidhje konkrete me çështjen
2 kundër z. Shala, relevanca ose lidhja me këtë lëndë gjyqësore
3 duhet që të përcaktohet paraprakisht.

4 Kështu që për momentin, pyetja që kam për ju është: A do
5 të japë dëshmitari juaj ndonjë informacion lidhur me
6 fabrikimin e mundshëm të provave në çështjen 4? A ka një
7 lidhje të drejtpërdrejtë të këtij dëshmitari me këtë pyetje që
8 u bëra, Avokat? Sepse ajo çfarë nuk duam që të ndodhë këtu në
9 Gjykatë dhe, që nuk do të lejojmë që të ndodhë, është që të
10 kemi ashtu siç e thoni ju, siç është formulimi juaj pra të
11 kemi informacion kontekstual historik në qoftë se Trupi
12 Gjykues nuk e kupton se ky informacion historiku apo
13 kontekstual lidhet me këtë lëndë gjyqësore.

14 Kështu që vërtetë më duhet një përgjigje e qartë lidhur
15 me këtë pyetje, pra, me aq sa dimë deri tani mbështetur në atë
16 çfarë na keni dhënë, e kemi lexuar me kujdes, e kemi studiuar
17 me kujdes, por unë personalisht nuk pashë asgjë që nënkupton
18 që ky dëshmitar do të thotë diçka konkrete lidhur me këtë
19 çështje, domethënë, që ka të bëjë me fabrikimin lidhur me këtë
20 çështje.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Në qoftë se do më lejoni, dua të
22 që filloj me përgjigjen. Dhe pastaj z. Aouini mund të shtojë
23 lidhur me këtë.

24 Mendoj që kemi qenë të qartë në dosjen paraprake si dhe
25 në deklaratën paraprake lidhur me këtë. Është një çështje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 18

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 shumë delikate që të provohet dhe të mbrohet --

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
3 ju duhet që të mbroheni asgjë. E kemi kaluar këtë pjesën.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Teza e keqmenaxhimit të hetimeve
5 dhe mundësia që shërbimet e sigurimit serb kanë një rol
6 kryesor në këtë. Ky është një proces i cili duhet që të
7 funksionojë siç duhet dhe duhet që të shkojë gradualisht hap
8 pas hapi, në qoftë se neve fillimisht nuk na jepet mundësia që
9 të themi dhe që paraqesim përpara jush që Aparati i Sigurisë
10 Serbe, siç është njohur vetë nga sistemi serb gjyqësor. Dhe në
11 disa vendime kemi mundësi që të flasim për këto dhe
12 dëshmitari, jam i sigurtë, që do të flasë lidhur me këto. Dhe
13 sipas pikëpamjes tonë ky është hapi i parë, kjo është gjëja e
14 parë që duhet të bëjmë.

15 Më pas do t'ju japim ju mundësinë që të kuptoni metodat e
16 përdorura nga shërbimi dhe ne do të kemi mundësi që t'ju
17 tregojmë juve dhe mendoj që do ju japim mundësinë që ju të
18 shikoni që vërtetë kjo ka lidhje me çështjen e z. Shala. Kjo
19 është mënyra sesi ne mendojmë se duhet vijuar më tej. Pra,
20 sipas mendimit tonë, kjo është mënyra e duhur që duhet të
21 ndjekim, rruga e duhur që duhet të ndjekim, pra, duhet që t'ju
22 japim disa prova që ju të shikoni me sytë tuaj dhe që ju të
23 keni mundësi që të njiheshin me to dhe që të keni mundësi që
24 të identifikoni mundësinë reale. Dhe më duhet të them që ky
25 është thelbi i Mbrojtjes.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 19

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Sepse sikurse e dini, z. Shala pretendon që nuk ka qenë
2 aty, nuk ka qenë pjesë e këtyre krimeve fare. Edhe në qoftë se
3 kanë ekzistuar këto krime, në qoftë se janë kryer këto krime,
4 ai nuk ka qenë fare i pranishëm. Megjithatë, më shumë sesa
5 kaq, qëndrimi i Mbrojtjes është që akuzat kundër z. Shala mund
6 të jenë ngritur për shkak se ne kemi pasur problem real në
7 hetim, pra, problemi mund të ketë qenë me Prokurorinë. Nuk
8 është se po akuzojmë Prokurorinë. Se sigurisht ne nuk jemi
9 fëmijë. Megjithatë mënyra e përdorimit të hetimeve, hetime më
10 shumë sesa 20 vite të gjata ne e dimë se ç'a problemesh ka një
11 proces i tillë dhe ne e dimë shumë mirë se çfarë ndodhë me
12 kalimin e kohës. Për shembull, në një pamje të parë në qoftë
13 se shikon dokumentin e parë është dokumenti i Prokurorisë
14 është shumë i dyshimtë, domethënë, është një dokument i
15 çuditshëm në kuptimin që nuk është i nënshkruar, nuk ka vulë
16 të hetimit, të duket sikur është një dokument fals i rremë.

17 Dhe ju duhet që ta kuptoni që pothuajse 10 vite hetimi në
18 vetvete nuk e kanë çuar, nuk e kanë bërë këtë test të vërtetë.

19 Dosja e dhënë nga Prokurori dhe të njëjtin informacion ne
20 e kemi edhe nga hetimet e kryera prej nesh, pra, dosja e
21 Prokurorit dhe hetimet ton ana demonstrojnë që teza mbi të
22 cilën është ndërtuar aktakuza është bërë e mundur vetëm pas
23 ndërhyrjes së disa mediave serbe. Në fakt, kjo është pjesë e
24 dosjes së Prokurorit, e dokumenteve të Prokurorit.

25 Kështu që ne e dimë që [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 20

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [REDAKTUAR], janë krijuar disa lidhje me forcat e
2 sigurimit serb në Serbi, por madje dhe në Kosovë dhe për këtë
3 arsye ne mendojmë që kjo është një çështje shumë e rëndësishme
4 dhe shumë e rëndë dhe që duhet të sillet në vëmendjen tuaj.

5 Megjithatë duhet që të shtoj dhe, ju kërkoj ndjesë për
6 kohën, por dua ta theksoj këtë gjë, por Mbrojtja duhet të jetë
7 e lirë për zgjedhjen e dëshmitarëve të vet, për paraqitjen e
8 dëshmitarëve të çështjes së vet, të paraqitjes së provave të
9 veta. Domethënë në qoftë se e besoni ju ose s'e besoni ju
10 është tjetër gjë. Ju jeni ata që do të duhet të vlerësoni këtë
11 gjë. Por në qoftë se ju nuk na jepni mundësinë që ne të
12 paraqesim lëndën tonë, provat tona, siç e mendojmë ne të
13 vlefshme. Atëherë i takon që kjo nuk është Mbrojtje efektive.
14 Dhe nuk është gjykim i drejtë. Dhe në qoftë se nuk i jepet
15 mundësi Mbrojtjes që të paraqesë lëndën e vetë siç duhet,
16 atëherë procesi gjyqësor do të jetë i çalë, jam i sigurt që ju
17 pajtoheni me këtë qëndrim timin. Unë e vlerësoj shumë dhe
18 shpresoj që ky Trup Gjykues e kjo Gjykatë t'i lejojë të
19 akuzuarit që të ketë një mbrojtje efektive realisht. Dhe për
20 këtë arsye ne themi që thelbi i Mbrojtjes është kjo.

21 Nuk mjafton, nuk mjafton për Mbrojtjen për të thënë që z.
22 Shala nuk ka qenë i pranishëm atje. Kjo nuk mjafton për ju dhe
23 ju e dini që ka prova për këtë, pra, ne këtë ë frëngjisht e
24 quajmë, pra, *provat diabolike ose devil evidence, decol*
25 *diabolik*. Dhe për këtë arsye, ne i kërkojmë Trupit Gjykues që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 21

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 të pranojë dëshmitarë që kanë qenë aty dhe janë në gjendje që
2 të vijjnë këtu dhe të thonë nën betim që: Unë kam qenë aty, kam
3 qenë në atë vend për disa javë, për disa muaj dhe nuk e kam
4 njohur z. Shala, nuk e kam parë z. Shala. Por Ujkun nuk e kam
5 njohur, nuk e kam parë.

6 Megjithatë kjo nuk mjafton. Kështu që për këtë arsye, ne
7 e mendojmë që duhet të themi shumë më tepër sesa kaq, sipas
8 mendimit tonë, këto akuza që janë zgjedhur me lirinë e
9 Mbrojtjes, sigurisht me pajtimin e z. Shala, pa diskutim kjo,
10 pra, ne duam që t'ju themi ju, të nderuar Gjykatës, që si
11 është e mundur që z. Shala të akuzohet dhe të vazhdojë të jetë
12 i akuzuar nga disa persona dhe mbase ose pretendohet që të
13 jenë viktimë të ca dhune, apo krime, apo shkelje të së drejtës
14 humanitare ose të drejtës penale. Por këto nuk janë lojëra
15 olimpike. Ti mund të jesh viktimë e disa fakte, po pastaj të
16 vish dhe të gënjesh për disa detaje të viktimizimit tënd është
17 tjetër gjë dhe në qoftë se ti thua që do shtojë dhe dikë
18 tjetër tek kjo vorbulla e dhunës sepse kam ca mosmarrëveshje
19 me këtë burrë apo me këtë grua, ose kam ca gjëra për të larë
20 ose për t'u hakmarrë, këto janë fjalët e përdorura prej disa
21 dëshmitarëve.

22 Dhe ky është qëllimi i Mbrojtjes, jam i sigurt që ky
23 është një qëndrim i vështirë dhe real, po nga ana tjetër mund
24 të jetë i shkëlqyer, mund të jetë brilant si zgjedhje. Sepse
25 si pjesë e këtij hetimi për këtë çështje, nuk po flas për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 22

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 çështjet e tjera, flas për këtë çështje gjyqësore se nuk janë
2 puna ime çështjet e tjera gjyqësore. Pra, nëse ne jemi në
3 gjendje që t'ju themi që duhet të fshehim në mënyrë të
4 përgjithshme dhe, pra, duhet që të ngjizim hetimet dhe t'ju
5 themi që këto vështirësi ose këto pika specifike të hetimeve
6 dhe mënyra sesi janë kryer këto hetime janë të njëjtat që do
7 të na duhet të përballlemi në rastin kundër z. Shala. Sepse kur
8 ju përpiqeni që të bëni, ju kërkoj ndjesë për fjalën, pra,
9 lojëra olimpike për një problem real, për një skenë reale për
10 raste dhune, ju e bëni situatën gjithmonë e më të madhe dhe
11 përfshin kaq shumë njerëz e dhunë edhe situata bëhet shumë
12 disproporcionale, unë ju besoj tërësisht dhe besoj se do më
13 mirëkuptoni. Është e vështirë kjo për ne, është shumë e
14 vështirë. Po hap pas hapi. Dhe ky është hapi i parë që ne po
15 ndërmarrim.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit për parashtrimin tuaj.

18 Kam disa pyetje vijuese. Ne nuk e kundërshtojmë, mos më
19 keqkupto, ne nuk e kundërshtojmë qëndrimin tuaj kur thoni që
20 Mbrojtja duhet ta zgjedhë vetë mënyrën sesi e mbron çështjen e
21 vetë gjyqësore. Kjo është e padiskutueshme.

22 Për ne, si Trup Gjyqësor, që dëshmitari që do të thërritet
23 nga Mbrojtja - dhe kjo është dhe arsyeja pse po i kushtojmë
24 kaq kohë edhe kësaj bisede - pra, lidhja me lëndën gjyqësore
25 çfarë sjell ky dëshmitar për këtë lëndë gjyqësore, a mund të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 23

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 na japë ne ky person dëshmi. Dhe duhet ta vërtetojmë këtë
2 lidhje.

3 Pra, kriteri i relevancës apo i lidhjes në vetvete është
4 shumë i gjerë po një nga pyetjet që lind tani është kjo, ju
5 s'jeni përgjigjur në fakt në thelb kësaj. Unë e kuptoj që
6 dëshmitari mund të flasë për fabrikime të mundshme të
7 pretenduar provash nga autoritetet serbe, e më konkretisht,
8 unë e lexova dhe në dokumentin tuaj, nga Shërbimi Sekret Serb.

9 Ne lexuam për të ndaluarit që janë rekrutuar, sipas
10 dokumentit që na dhatë ju. Lexuam për pretendimet, përgatitjen
11 e pretenduar të dëshmitarëve. Pamë librin. E lexuam librin
12 pjesët që ju na udhëzuan të lexonim. Të gjitha këto mund të
13 jenë kontekstuale, mund të jenë informacion kontekstual që ka
14 lidhje, por për Trupin Gjykses ajo që mungon është lidhja
15 konkrete me këtë lëndë gjyqësore, me këtë çështje gjyqësore.

16 Dhe unë po ju pyes tani: Ky dëshmitar, apo një dëshmitar
17 tjetër në të ardhmen a do të na tregojë apo do të japë dëshmi,
18 e thënë ndryshe, a do të japë dëshmi lidhur me faktin cilët
19 dëshmitarë qenkan këta që kanë fabrikuar informacion? Se nuk
20 keni përmendur fare në dokumentet që kemi kërkuar. Pamë dhe
21 referencën në transkript. Dëgjuam çfarë tha dëshmitari. Po në
22 asnjë vend ama nuk lexova ndonjë gjë lidhur me këtë dëshmitar
23 konkret apo ndonjë dëshmitar tjetër të ardhshëm ë çështjen e
24 z. Shala nga Prokuroria. Pra, e thënë ndryshe që dëshmitari që
25 do thërrisni mund të na japë dëshmi lidhur me këto pika.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 24

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Prandaj unë po ju pyes për çfarë temash konkrete. Një e thatë
2 një ju, ishte prania e z. Shala. E thashë me fjalët e mia - më
3 korrigjoni në qoftë se unë bëj një përmbledhje që nuk është e
4 saktë, keni të drejtën të më korrigjoni edhe me kënaqësi e
5 pranoj - pra, ju po thoni që ka dëshmitarë në këtë çështje
6 gjyqësore, në çështjen e paraqitur nga Prokuroria një, dy,
7 tre, katër, nuk e di sesa, të cilët kanë fabrikuar provat
8 lidhur me disa aspekte. Dhe një nga aspektet ishte që z. Shala
9 nuk ka qenë atje dhe ata thonë që ka qenë atje. Por dhe lidhur
10 me pika të tjera. Dhe dua të m'i thoni ju pikat e tjera.

11 Për ne, nuk mjafton që ju thjesht të na thoni tani që ky
12 dëshmitar do të jap informacion kontekstual sa i takon
13 çështjes 04, ai nuk di gjë për këtë se s'ka qenë i përfshirë,
14 por gjithashtu nuk është e sigurtë a do thonë diçka të
15 ngjashme dëshmitarët të ardhshëm për çështjen 04.

16 Duhet të kuptoni që ne si Trupi Gjykses, ose të paktën
17 unë nuk do ta lejoj, që këtu në sallën e gjyqit të flasim për
18 gjëra, nuk po them ka ndodhur apo s'ka ndodhur, po nuk duhet
19 të flasim për gjëra që nuk lidhen me këtë çështje gjyqësore.
20 Dhe unë ju dëgjova me vëmendje, unë prapë nuk po e shoh
21 lidhjen. Më duhet të më vërtetoni lidhjen. Është shumë e
22 thjeshtë. Sepse po flasim për gjëra kot këtu, po flasim për
23 gjëra që s'kanë lidhje fare me çështjen gjyqësore. Ju duhet të
24 më jepni këtë lidhje dhe duhet më garantoni ju, nuk më thatë
25 asgjë nga gjërat që ju thatë tani, nuk ma tregon prapë lidhjen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 me çështjen tonë gjyqësore. Pikërisht kjo më nevojitet.

2 Kjo ishte pika që doja të ngrija do i jap fjalën edhe
3 ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave, nëse kanë diçka për të
4 shtuar. Po fillimisht përfundojmë bashkë.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Përpara se t'i jap
6 fjalën z. Aouini, dua të përfundoj shpjegimin tim.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Doni
8 ta përfundoni. Në rregull.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë private)

Faqe 26

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë private)

Faqe 27

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë private)

Faqe 28

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F744*
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

7 rregull. Faleminderit. Nëse donit të thoni këtë -- në qoftë

8 se ishte ky materiali që deshët të thoshit, faleminderit.

9 Prokurore, deshët të shtoni gjë sepse nuk keni thënë ende
10 gjë?

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Çfarë?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Diçka
13 të re ju lutem. Diçka që nuk e keni dhënë në parashtrimin tuaj
14 me shkrim.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] *Modus operandi* për të cilin
16 mund të jap dëshmi ky dëshmitar, sikurse thamë ka të bëjë me
17 faktet dhe me situatat që janë krejt ndryshe, jo vetëm të
18 ndara në afate kohore dhe vende të tjera. Po, në fakt, do
19 përsëris veten me këto që do them.

20 Por nuk lidhet me fakte të tjera, nuk ka lidhje me këtë.
21 E para, ka ndodhur në një lokal në një qytet ku ka ndodhur një
22 grup me persona të armatosur që hynë aty dhe vranë njerëz. Dhe
23 nuk e dimë sa e vërtetë është, kuptohet kjo, sepse nuk ka
24 lidhje me këtë çështje gjyqësore.

25 Po ne po flasim për një bazë të UÇK-së, kjo është çështja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 30

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 jonë. Kemi dëgjuar dëshmi që atje ka pasur ushtarë. Kanë qenë
2 të organizuara nga udhëheqësit e UÇK-së, ata kanë qenë të
3 pranishëm. Po në këtë rast nuk kemi lidhjen.

4 Pra, *modus operandi* i veprimeve të pretenduara në këtë
5 rast ka lidhje me fakte të tjera dhe ne nuk na hynë në punë,
6 nuk është e dobishme për ne dhe nuk do përdorim në mënyrë
7 efikase kohën gjyqësore. Unë kaq kisha për të thënë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Mbrojtësi i Viktimave?

10 Z. LAWS: [Përkthim] Pajtohem që nuk ka lidhje. Mbrojtjes
11 i është kërkuar konkretisht të japë dëshmi, të tregojë lidhjen
12 mes dëshmisë së këtij dëshmitari në çështje 04 dhe për ne nuk
13 është dhënë dëshmia, nuk është vërtetuar kjo lidhje në këtë
14 çështje gjyqësore nga ky dëshmitar. Dhe nuk duhet të jetë e
15 pranueshëm për këtë çështje gjyqësore.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
17 Po jap disa udhëzime tani.

18 Avokati Mbrojtës, ajo që do të bëjmë ne tani, do bëjmë
19 këtë. Do ju lejojmë t'i bëni disa pyetje lidhur me fabrikimin
20 e mundshëm të dëshmimeve nga autoritetet serbe, po brenda kuadrit
21 që ju sapo na parashtuat këtu, konkretisht për gjërat e tjera
22 nuk dua të më thoni asgjë. Për ato që folëm pak më herët dhe
23 thashë që s'kanë lidhje, nuk dua që t'i shtjelloni më tej. Do
24 ndryshojmë fokusin dhe unë nuk do ju lejoj, do ju kontrolloj
25 sistematikisht në lidhje me këtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 31

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Gjithashtu unë do t'ju udhëzoj gjatë gjithë kohës, në
2 qoftë se nuk do ta bëni ju, do ta udhëzojë unë dëshmitarin,
3 unë dua të dëgjoj a ka gjë që dëgjoj a ka gjë konkrete për të
4 thënë për çështjen 04, për këtë çështje gjyqësore.

5 Pra, ne duam të dimë nëse ka dijeni për ndonjë fabrikim
6 të mundshëm të dëshmime për këtë çështje gjyqësore.

7 Kështu do të veprojmë. Unë do ju jap hapësirë, do ju jap
8 mundësi, po do ketë disa kufij dhe unë do ta ndërpresë vetë
9 dëshmitarin në qoftë se gjykoj që po shkon përtej asaj që duam
10 të dëgjojmë.

11 Ky është udhëzimi im.

12 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë publike sërish.

13 Dhe ndërkohë është informuar dëshmitari që do të zgjasë
14 pak më shumë fillimi i dëshmisë, ndonëse e kishin informuar që
15 në mëngjes që do të duhej të priste pak paradite. Ja dhamë
16 informacionin e nevojshëm.

17 ~~{Seancë e hapur}~~

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Sa i takon kërkesës së Mbrojtjes për të përdorur
22 materialet e nxjerra rishtazi, konkretisht DPS00877-ET pra,
23 DPS00876-ET dhe DPS00877-ET dhe në anglisht që janë përkthimet
24 e rishikuara të dy përkthimeve që ishin përgatitur fillimisht
25 nga Mbrojtja miratojmë kërkesës e Mbrojtjes për të përdorur

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 këto dokumente, pasi u nxorën në kohën e duhur dhe menjëherë
2 pasi i kishin marrë.

3 ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave ka pasur kohë të
4 mjaftueshme t'i lexojnë dhe do jenë të dobishme për të
5 ndihmuar në dëshminë e këtij dëshmitari dhe nuk u paraqit
6 asnjë kundërshtim nga ZPS-ja apo Mbrojtësi i Viktimave.

7 Ky ishte urdhri i katërt me gojë.

8 Është shumë e rëndësishme. Diçka që dua të them tani një
9 udhëzim për z. Mahmuti, dëshmitarin e sotëm dhe këtë duhet ta
10 bëjmë në seancë private.

11 Do ju lutesha dhe njëherë Sekretares së Gjykatës të
12 kalonim në seancë private.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë private)

Faqe 33

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 jemi në seancë publike.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, znj. Sekretare.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Sa i takon mesazhit që na dërguat me postë elektronike
2 sot për kundërshtimin e dokumenteve të propozuara nga ZPS-ja,
3 për marrjen e dëshmitarit në pyetja ZPS-ja, Trupi Gjykues ju
4 udhëzon që të na dërgoni një përmbledhje të dokumenteve për të
5 cilat ju keni kundërshtime përmes postës elektronike, se
6 aktualisht nuk e dimë se për cilët dokumente bëhet fjalë dhe
7 na tregoni shkurtimisht se për çfarë flasin këto dokumente.
8 Pra, duke parë deri në çfarë pike, domethënë, si do të
9 vazhdojmë me marrjen në pyetje të këtij dëshmitari atëherë
10 ndoshta sot pasdite mund të përfshijmë dhe mundësinë e ZPS-së
11 që të kundërpërgjigjet për parashtrimin tuaj. Megjithatë le ta
12 shikojmë si do shkojë sot. Dhe mendoj që në qoftë se do na
13 kërkohet që t'i shikojmë të gjitha dokumentet për njëherë do
14 jetë paksa e lodhshme.

15 Atëherë ky është përfundimi i udhëzimeve të Trupit
16 Gjykues. Mund të vazhdojmë tani me dëshminë e dëshmitarit.

17 Z. Mahmuti do japë dëshmi pa masa mbrojtëse, ne në parim
18 do jemi këtu në sallën e gjyqit për dy seanca për një orë e
19 gjysmë por megjithatë varet sesi do shkojë procesi. Duke e
20 parë e duke bërë, ndoshta mund të kemi një pushim dreke më të
21 shkurtër, megjithatë duke parë e duke bërë.

22 Do i kërkoja Sekretares që ta sjellë dëshmitarin në
23 sallën e gjyqit.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 36

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Mirëmëngjes, z. Mahmuti. Mirë se erdhët në Dhomat e
2 Specializuara të Kosovë.

3 DËSHMITARI: Mirëmëngjes. Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Shala, e dëgjuat z. Mahmuti?

6 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po e ndëgjova. Ju
7 faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Mahmuti, si je?

10 DËSHMITARI: Shumë mirë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit. Sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Përpara
13 sesa të fillojmë kam disa komente që dua t'jua sjell në
14 vëmendjen tuaj. Në rregull?

15 Jeni thërritur që të jepni dëshmi përpara ZPS-së, përpara
16 Trupit Gjykues në çështjen Prokurori i Specializuar kundër
17 Pjetër Shalës në mënyrë të tillë që ta ndihmoni Trupin Gjykues
18 për të arritur në një vendim. Së pari, do të lexoni betimin
19 solemn për të thënë të vërtetën dhe më pas do t'ju bëhen
20 pyetje së pari nga Mbrojtja e të akuzuarit dhe më pas nga
21 prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, nga
22 Mbrojtësi i Viktimave që është nga ana tjetër që është ulur
23 afër jush dhe pastaj edhe anëtarë të Trupit Gjykues mund të
24 kenë pyetje për ju.

25 Përpara sesa të lexoni betimin solemn për të thënë të

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 vërtetën, dëshiroj që t'ju jap disa udhëzime dhe këshilla
2 praktike për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që do t'ju bëhen.

3 Z. Mahmuti, ju lutem dëgjoni me kujdes pyetjet që do t'ju
4 bëhen, në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje të caktuar mund
5 t'i kërkonte personit që ju bën pyetjen që t'ua përsërisë edhe
6 njëherë pyetjen ose t'jua sqarojë atë.

7 Ne duam që ju të thoni të vërtetën, të na tregoni që
8 çfarë keni parë vetë, çfarë keni përjetuar vetë, çfarë keni
9 dëgjuar, çfarë keni ndjerë.

10 Ose në qoftë se një informacion nuk e ke dëgjuar vetë
11 personalisht por që e ke marrë vesh ndryshe, ju lutem na e
12 thoni këtë gjë dhe na e shpjegoni sesi e keni marrë vesh një
13 informacion të caktuar.

14 Mund të mos ju kujtohen të gjitha hollësitë e lidhura me
15 ngjarje ose me data të caktuara, nuk ka ndonjë problem fare
16 lidhur me këtë. Vetëm duhet të na thoni gjërat që dini.

17 Nuk duhet të hamendësosh. Nuk duhet që t'i ngatërrosh
18 gjërat kur nuk i di. Nuk ka asnjë lloj problemi që në qoftë se
19 nuk i di gjërat që thoni "Nuk e di" dhe kaq. E shoh që po
20 tundni me kokë, besoj që është e qartë për ju.

21 DËSHMITARI: Plotësisht.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
23 ashtu ju lutem jepini përgjigje pyetjeve që ju bëhen. Në qoftë
24 se ne do të na duhen sqarime të mëtejshme, do ju kërkojmë që
25 të jepni më shumë sqarime. Kështu që thjesht jepini përgjigje

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 pyetjes që ju bëhet mos thoni gjëra të tjera që shkojnë përtej
2 pyetjes.

3 E kuptuat gjithë këtë, z. Mahmuti?

4 DËSHMITARI: Po.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
6 mirë.

7 Kam gjithashtu edhe disa këshilla praktike për dëshminë
8 përpara Trupit Gjykes. Ju lutem mbani parasysh sa më poshtë.

9 Çdo gjë që ne themi këtu përkthehet dhe mbahet në
10 procesverbal, kështu që është e rëndësishme që të flisni
11 përpara mikrofonit që keni aty përpara, është e rëndësishme që
12 të mos flisni shumë shpejt dhe është e rëndësishme që të
13 flisni qartë. Ajo çfarë është shumë e rëndësishme po ashtu
14 është që ju nuk duhet të filloni të flisni ndërkohë që personi
15 që bën pyetjen vazhdon duke folur, domethënë, me fjalë të
16 tjera prisni të përfundojë pyetjen personi që bën pyetjen,
17 bëni një pauzë prej pesë sekondash dhe pastaj fillo të flasësh
18 të japësh përgjigje. Kjo do t'i lejojë përkthyesit tanë të
19 mbarohet përkthimi dhe të fillohet sërish pastaj me përkthimin
20 e përgjigjes tuaj. Në qoftë se nuk bëni këtë pauzën do të kemi
21 folës që mbivendosen dhe kjo i komplikon pak gjërat,
22 ndonjëherë i bën edhe të vështira për ne për t'i kuptuar.
23 Kështu që ky është një koment shumë i rëndësishëm.

24 Nëse e ngre dorën, ju lutem ndaloni së foluri sepse jo
25 gjithmonë mund ta them një gjë të tillë sepse në qoftë se e

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 them unë, i takon që të mbase do të duhet që të flasë mbi dikë
2 tjetër, të mbivendoset e folura. Kështu që ndonjëherë e bëj me
3 dorë dhe në qoftë se e shikon këtë gjestin me dorë duhet të
4 ndaloni.

5 Ndonjëherë mundet të na duhet që t'ju kërkojmë që të
6 largoheni nga salla e gjyqit sepse na duhet të diskutojmë
7 përmbajtjen e pyetjeve që do t'ju bëhen. E dimë që ju dini pak
8 anglisht, kështu që nuk duam që të ndikojë mbi ju nuk duhet të
9 kemi ndonjë influencë mbi ju me diskutimet që kemi kështu që
10 mund t'ju kërkojmë që të dilni nga salla dhe të vini prapë.

11 Nëse ju keni pyetje ose në qoftë se keni nevojë për
12 pushim, në qoftë se ju nevojitet diçka, lirisht mund të ngrini
13 dorën dhe unë do t'ju jap fjalën në mënyrë të tillë që ju të
14 shprehni shqetësimin ose pyetjet çfarë keni.

15 A janë të qarta këto?

16 DËSHMITARI: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Z. Mahmuti, sikurse bëj me të gjithë dëshmitarët e tjerë,
20 tani do ju kërkoj që të lexoni betimin solemn për të thënë të
21 vërtetën. Ju kujtoj që është vepër penale në juridiksionin e
22 Dhomave të Specializuara të Kosovës që të jepni dëshmi të
23 rreme.

24 Znj. Sekretare, ju lutem jepini z. Mahmuti tekstin e
25 betimit solemn.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 40

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1

2 Z. Mahmuti, lexoni tekstin që keni përpara.

3 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
4 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
5 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
6 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

7 DËSHMITARI: Bardhyl Mahmuti

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit. Tani je nën betim për të thënë të vërtetën, z.
10 Mahmuti.

11 Avokat, keni tre orë në dispozicion për të bërë pyetjet
12 për dëshmitarin. Ju lutem informoni Trupin Gjykes në qoftë se
13 ka ndonjë ndryshim lidhur me afatin e kohës që keni kërkuar.

14 Mund të fillojmë tani me dëshminë e dëshmitarit.

15 E keni fjalën ju.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
17 Gjykatëse.

18 Pyetje nga z. Gilissen:

19 Z. GILISSEN: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

21 PË. Mirëmëngjes.

22 PY. Si je?

23 PË. Shumë mirë.

24 PY. Tani do të fillojmë me disa pyetje. Në qoftë se jeni gati
25 mund të fillojmë. Dua që të fillojmë me disa pyetje personale.

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 41

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. Dëshmitar, a mund të na thoni si e keni emrin dhe si e
2 keni mbiemrin?

3 PË. Quhem Bardhyl Mahmuti.

4 PY. A keni aktualisht ose a keni pasur në të shkuarën një
5 nofkë?

6 PË. Jo.

7 PY. Shumë faleminderit. Si quhet babai juaj?

8 PË. Beqir.

9 PY. Me pak fjalë me çfarë veprimtarish profesionale është
10 marrë babai juaj?

11 PË. Babai im ka qenë këshilltar i arsimit për komunën e
12 Tetovës dhe Gostivarit gjatë periudhës 1966, 1968, dhe në të
13 njëjtën kohë ka qenë profesor i filozofisë, i logjikës dhe i
14 sociologjisë në gjimnazin "Keril Peqinoviç" në Tetovë

15 PY. Shumë faleminderit. Me pak fjalë, po veprimtaria
16 profesionale e nënës tuaj cila ka qenë?

17 PË. Nëna ime amvisë. Dhe është përkujdesur në çështjet e
18 shtëpisë, me përkujdesjen çka kërkon një familje.

19 PY. A ka pasur përfshirje politike, domethënë, prindërit tuaj
20 kanë qenë politikisht të përfshirë?

21 PË. Duke qenë në një funksion që lidhet me arsimin, prindi im
22 është përpjekur të hapë paralelin në gjuhën shqipe që nxënësit
23 shqiptarë të kenë mundësi të shkollohen në gjuhën shqipe.

24 Pikërisht për këtë angazhim ai është dënuar, është arrestuar
25 fillimisht në janar të vitit 1969, kur kam pasë unë nëntë

1 vjet, ende s'i kam mbushë, kam qenë tetë vjet e diçka s'kam
2 qenë nëntë vjeçar, kur kanë ardhë njësitë speciale të shtetit
3 jugosllav kanë hyrë në shtëpi dhe kanë përmbysur çdo gjë. Kanë
4 arrestuar babin tim dhe e kanë dënuar me një vit burg si
5 nacionalist vetëm e vetëm pse ka dash që shqiptarët të
6 arsimohen në gjuhën shqipe.

7 Pas vuajtjes së dënimit ai nuk ka mund të gjejë punë në
8 vendlindje dhe është shpërngulë në Prishtinë, në Kosovë, ku ka
9 gjet punë fillimisht në entin e mjeteve të teksteve mësimore
10 dhe më vonë ka qenë redaktor në gazetën Shkëndija, që ka qenë
11 një gazetë pedagogjike për arsimin në Kosovë. Gjatë gjithë
12 kohës dhe në pension ka qenë anëtar i redaksisë si redaktor i
13 kësaj gazete. Është pensionuar në vitin 1990.

14 PY. Shumë faleminderit. A mund të themi që familja juaj ka
15 qenë politikisht e angazhuar?

16 PË. Familja ime ka qenë politikisht e angazhuar me realizimin
17 e të drejtave tona kombëtare. Babai im, mixha im, Enveri dhe
18 disa anëtarë të familjes, kushërinj në familjen tonë kanë qenë
19 veprimtarë të çështjes kombëtare sepse kanë qenë të
20 vetëdijshëm që diskriminimi hiqet vetëm përmes një angazhimi
21 politik.

22 PY. Shumë faleminderit. Shumë e qartë. Faleminderit. A mund
23 të na thoni çfarë arsimit keni?

24 PË. Unë kam kryer shkollën fillore pjesërisht në qytetin e
25 lindjes në Tetovë, pjesërisht në Prishtinë. Edhe në Prishtinë

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 43

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 kam kry dy vitet e para të gjimnazit, pastaj dy vitet e fundit
2 i kam kry në qytetin e lindjes time në Tetovë. Kemi bë vajtje
3 ardhje në vazhdim --

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Mjafton që thjesht të na jepni nivelin më të lartë të arsimit
6 nuk është e thënë që të fillosh nga arsimi fillor, domethënë,
7 na thoni çfarë diplome më të lartë keni.

8 DËSHMITARI: Kam diplomën e Fakultetit të Shkencave
9 Politike në Universitetin e Lozanës, kam diplomën e
10 magjistraturës si cikël i tretë, fillova ciklin e tretë në
11 universitetin e Lozanës gjithashtu në Fakultetin e Shkencave
12 Politike. Edhe projekti i tezës së doktoraturës është miratu
13 në atë universitet, po për shkaqe të angazhimeve politike në
14 kohën e luftës dhe të pas luftës, unë i kam ndërpre dhe nuk
15 kam vazhduar tezën e doktoraturës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit.

19 PY. Çfarë profesioni keni? Çfarë pune bëni tani?

20 PË. Aktualisht jam edukator që shoqëroj fëmijët që kanë
21 vështirësi goftë në sistemin shkollor, goftë në problemet për
22 integritet shoqërorë. Jam punëtor në OZEO Vaud që është një
23 strukturë në kantonin Vaud sepse Zvicra përbëhet nga 26
24 kantone, për ata që nuk e dinë dhe OZEO është një strukturë në
25 tërë Zvicrën, unë jam në pjesën e kësaj strukture që lidhet me

1 kantonin e Vaud që shoqëron njerëzit në vështirësi për t'u

2 integruar qoftë në sistemin arsimor qoftë në shoqëri.

3 PY. Sociolog jeni? Kështu apo jo?

4 PË. Jam politolog.

5 PY. Politolog. Në rregull. Faleminderit. Dëshiroj t'ju bëj

6 disa pyetje që kanë të bëjnë me UÇK-në.

7 Së pari dua t'ju pyes a ke pasë ndonjëherë ndonjë kartë

8 anëtarësimi në UÇK?

9 PË. Në UÇK nuk ka pasur karta anëtarësimi sepse nuk ka qenë

10 parti politike. Unë kam qenë anëtar i Lëvizjes Popullore të

11 Kosovës, ka qenë një organizatë patriotike e cila ka pasë tri

12 objektiva të veta të mbrojtje politikisht luftën e drejtë --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Ndjesë, Dëshmitar. A ke qenë pjesë e UÇK-së? Kjo ishte pyetje.

15 A ke qenë ndonjëherë pjesë e UÇK-së? Nuk është e nevojshme që

16 të vazhdoni më tej të jepni shpjegime patriotike dhe

17 pjesëmarrje në lëvizje patriotike.

18 Pra, dua t'ju them dhe njëherë Dëshmitar, që kur ju bëhet

19 pyetje jepini përgjigje pyetjes. Në qoftë se Mbrojtja

20 dëshiron, për shembull, që të dijë më tepër lidhur me një

21 lëvizje të caktuar politike ose diçka të caktuar, do t'ju bëj

22 pyetje të tjera pasuese në mënyrë që ta përdori në mënyrë

23 efikase kohën.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Ju lutem mundohuni të dëgjoni pra, të dëgjoni pyetjen dhe

1 të jepni përgjigje pyetjes.

2 Pyetja ishte, a keni qenë pjesëtar i UÇK-së
3 PY. Përgjigja ime sado që mund të duket e shmangur nga
4 objekti i pyetjes ka të bëjë sepse është lëvizja ajo që ka
5 krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Dhe duke qenë anëtar i
6 Lëvizjes Popullore, unë kam qenë edhe në strukturat e UÇK-së.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
8 mjaftonte po të thojë "Po kam qenë pjesëtar i UÇK-së".

9 Z. Avokat, mund të vazhdoni më tej.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
11 Gjykatëse.

12 PY. Kur jeni kyçur në UÇK?

13 PË. Nuk ka një datë të caktuar, por si njeri që jam angazhuar
14 në mbrojtjen politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës daton
15 në kontaktet e para që kam pasë me diplomatët amerikanë në
16 qershor të vitit 1998.

17 PY. Çfarë roli keni pasë juve në këtë organizatë, pra, në
18 UÇK?

19 PË. Kam qenë i ngarkuar që ta arsyetojë në rrafshin
20 diplomatik domosdoshmërinë e luftës çlirimtare dhe se kjo
21 luftë çlirimtare është e drejtë dhe e qëndrueshme.

22 PY. Ku e keni pasë bazës sa i takon aktiviteteteve tuaja me
23 UÇK-në? Ku keni qëndru, ku e keni pasë bazën sa i takon
24 aktiviteteteve me UÇK-në?

25 PË. Nuk kemi pasë një seli të veçantë si grup diplomatik,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 46

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 sepse veprimtarinë tonë e kemi zhvilluar në të gjitha shtetet
2 e Evropës perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në
3 secilin vend kemi pasur njerëz të cilët kanë qenë të ngarkuar
4 të përfaqësojnë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe
5 kanë udhëtuar në vazhdimësi në të gjitha këto vende për
6 kontaktet diplomatike të cilat kanë qenë në funksion të
7 legjitimitetit dhe të mbështetjes së luftës sonë çlirimtare. Nuk
8 ka qenë seli në një qytet apo në një shtet të caktuar.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokat, më lejoni që të bëj një pyetje shtaruese. Faleminderit.

11 Si do quanit funksionin tuaj brenda UÇK-së? Sepse shkrova
12 atë çfarë na thatë, pra, që keni qenë përgjegjës për
13 marrëdhëniet diplomatike, po çfarë emri, çfarë emërtimi ka
14 pasë pozicioni juaj?

15 DËSHMITARI: Kam qenë përfaqësues politik i Ushtrisë
16 Çlirimtare të Kosovës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim]

20 PY. Në këtë moment gjatë kësaj kohe ku keni jetuar?

21 PË. Kam jetuar në Zvicër, në Vedej, qytet ku jam edhe sot.

22 PY. A ke punuar në Zvicër dhe pastaj ke udhëtuar, je kthyer në
23 vendin tënd?

24 PË. Nuk kam punuar në atë kohë, sepse në atëkohë kam qenë
25 ende në studime sapo në vitin 1997 përfundova ciklin e

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 47

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 magjistraturës dhe regjistрова ciklin e doktoraturës dhe kam
2 qenë në studime dhe paralelisht me këtë kam qenë tërësisht i
3 angazhuar rreth mbrojtjes politike të Ushtrisë Çlirimtare të
4 Kosovës dhe mbrojtjes politike të luftës së Ushtrisë
5 Çlirimtare të Kosovës.

6 PY. Pra, në qoftë se e kam kuptuar drejtë dhe në qoftë se s'e
7 kam kuptuar ju lutem më korrigjo, domethënë, selinë ose bazën
8 e ke pasë në Zvicër. A mund të na tregoni se çfarë shtetesh
9 apo çfarë vendesh keni vizuar në periudhën e kohës kur keni
10 kryer veprimtari në kuadrin e UÇK-së?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
12 ndoshta do ishte mirë që të përcaktojmë një kohë për këtë se
13 duket shumë e gjerë pyetje dhe dua që të jetë pak më e
14 përqendruar pyetja.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim]

16 PY. Ju na shpjeguat që keni jetuar në Zvicër dhe që keni
17 udhëtuar shumë. Ju lutem na shpjegoni se në cilat vende ose në
18 cilat vende keni qenë?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
20 kohën kur keni qenë. Domethënë, nga cila kohë deri në cilën
21 kohë.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do bëj një pyetje të përgjithshme
23 për të krijuar një ide dhe pastaj sigurisht, domethënë, do të
24 bëj pyetjen që ka të bëjë me periudhën e aktakuzës. Pa
25 diskutim, domethënë, që kjo është një pyetje e rëndësishme që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 48

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 do ta trajtojmë, po do ta bëjmë më pas.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
3 dëgjuam që ka udhëtuar shumë. Mund ta themi, për shembull, nga
4 1 janari 1999?

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po do e bëj pyetjen pasardhëse,
6 do e them në prill të 1999, pyetjen tjetër.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 kuptoj këtë.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Por në fillim dua që të na thotë
10 se çfarë lloji veprimtarish ose aktivitësh ka pasur dhe
11 pastaj do ta pyes lidhur me periudhën e aktakuzës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
13 mirë atëherë i themi, domethënë, çfarë do themi që nga momenti
14 kur ishit pjesëtar i UÇK-së?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo thjesht është e rëndësishme që
16 të marrim një ide reale të veprimtareve të veta.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga
18 momenti kur filluat që të udhëtonit si përfaqësues politik i
19 UÇK-së, a mund të na jepni një përmbledhje të vendeve që keni
20 vizituar jashtë shtetit që prej atij momenti?

21 DËSHMITARI: Nga qershori i vitit 1998 deri në qershor të
22 vitit 1999 kam qenë shpesh në Francë, në Gjermani, në Angli,
23 kam qenë dy herë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kam qenë
24 në Itali, në Austri, kam qenë në Slloveni, kam qenë në
25 Shqipëri. Këto janë vendet që i kam frekuentu shumë shpesh në

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 49

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 atë kohë. Edhe pa lënë anash, kam qenë edhe në Belgjikë, kam
2 qenë edhe në Holandë, vende ku kam qenë, domethënë, kam qenë
3 në Holandë, kam qenë në shumë vende.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim]

5 PY. Në rregull. A mund të na thoni se ku keni qenë në

6 periudhën nga prilli deri në qershor të vitit 1999?

7 PË. Nga prilli, për të qenë sa më i hapur dhe i drejtë, ua
8 kam dorëzuar edhe atë pasaportë udhëtimit që kam pasë në atë
9 kohë sepse ajo është dëshmia më e mirë në cilat vende kam
10 udhëtuar sepse janë edhe vizat që më kanë autorizuar të dal
11 jashtë shtetit, po edhe në vendet ku kam qenë, domethënë, janë
12 vulat e hyrjes dhe vulat e daljes. Nga prilli, domethënë, deri
13 në qershor të 1999, kam qenë një herë në Shqipëri, kam qenë
14 disa herë në Francë, kam qenë në Gjermani, kam qenë në
15 Belgjikë, në Bruksel kam pasë për takime zyrtare.

16 PY. Po.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Znj. Kryetare, në qoftë se më
18 lejoni, dëshiroj që t'i tregoj këtë dokument të pasaportës së
19 dëshmitarit për të rifreskuar kujtesën dhe më pas të vazhdojmë
20 me përgjigjen e disa pyetjeve mbështetur në informacionet që
21 do të zbulojmë na këto dokumente.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 rregull. Mund të vazhdoni.

24 Znj. Sekretare, pasi t'ju jepet numri i dokumentit ju
25 lutem paraqisni në ekran dokumentin.

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 50

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit. Ju lutem
2 paraqisni në ekran materialin ERN DPS00880-DPS00896. Nuk është
3 dokument që duhet të paraqitet për publikun.

4 PY. Z. Dëshmitar, a e njihni këtë dokument, e keni parë më
5 përpara?

6 PË. Po.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të paraqisni faqen tjetër
8 të këtij dokumenti, znj. Sekretare?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faqja
10 e parë është njësoj për të gjithë? Por ndoshta faqja tjetër që
11 ka fotografinë e dëshmitarit.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po. Për këtë po kërkoj.

13 PY. A është pasaporta juaaj kjo?

14 PË. Po.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Znj. Kryetare, nuk e di për
16 kohën, por mbase do ishte mirë që të ndalojmë tani, është kohë
17 e përshtatshme apo jo, sepse në qoftë se fillojmë me pyetje
18 për pjesën tjetër të këtij grupi pyetjesh atëherë do na duhet
19 më shumë kohë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e
21 shoh. Ka ardhur koha që të bëjmë pushim. Megjithëse do më
22 pëlqente që të vazhdonim por ka ardhur koha të bëjmë pushim.

23 Faleminderit për menaxhimin e kohës, z. Gilissen.

24 Z. Dëshmitar, tani do bëjmë pushimin e parë, pushimin e
25 paradites, ju keni vetëm 20 minuta këtu në sallën e gjyqit,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 51

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 megjithatë është e rëndësishme që të bëjmë një pushim për të
2 gjithë, në veçanti për përkthyesit.

3 Kështu që tani do bëjmë pushim për 30 minuta dhe pastaj
4 do vijmë përsëri në sallën e gjyqit. Do i kërkojmë Sekretares
5 që t'ju sjellë përsëri në sallën e gjyqit. Për momentin
6 faleminderit për çfarë thatë dhe do shihemi përsëri për 30
7 minuta.

8 DËSHMITARI: Faleminderit.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 Do të bëjmë pushim për 30 minuta.

13 --- Pauza fillon në orën 11.00

14 -- Seanca fillon në orën 11.31

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

16 se u kthyet. Përpara se të thërrasim dëshmitarin, shoh që ZPS-
17 ja ka të njëjtin ekip, e njëjta gjë për Mbrojtësin e
18 Viktimave.

19 Por në të majtën --

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Pak a shumë jemi të njëjtët
21 persona, por jo fiks siç ishim.

22 Znj. Kailin Chen u largua dhe kemi Deborah Thiebaut që
23 është një stazhiere që është bashkuar me ne.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull, faleminderit. Vazhdojmë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 52

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Mund të sillni dëshmitarin brenda në sallën e gjyqit.

2 Po shoh nga Mbrojtja, po punoni për informacionin në
3 përgjigje të dokumenteve të ZPS-së. Po, në rregull.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
6 se u kthyet z. Dëshmitar.

7 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ja
9 jap sërish fjalën Avokatit Mbrojtës që të vijojë me pyetjet e
10 veta.

11 Avokat, po diskutoni lidhur me një dokument, duhet ta
12 nxjerrim edhe një herë në ekran. Kështu që po ju jap fjalën,
13 por thjesht për procesverbal po ju them që dokumenti duhet të
14 rishfaqet edhe një herë në ekran.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Z. Dëshmitar, mos hezitoni të më ngadalësoni, dhe ju
17 lutem dilni në temë kur jepni përgjigjen. Është më e mira për
18 kohën. E dimë që s'është gjithmonë e mundur, por këto janë
19 procedurat që duam të ndjekim.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të donim që të shfaqej dhe një
21 herë dokumenti, por në një faqe tjetër. Do i lutesha
22 Sekretares që të nxirret në ekran dokumenti DPS00880-DPS00896.
23 Faqja 30 e dokumentit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cilën
25 faqen dëshironi në ekran?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 53

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faqen 30. Kjo është faqja 6, më
2 falni, desha të thoja 16. Është faqja 16 e dokumentit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
4 kujt numrave po u referoheni? Lart, djathtas? A mund të ndiqni
5 rendin ju lutem? DPS dhe pastaj jepni numrat, sepse jemi te
6 880 tani, tek faqja 880.

7 [Mbrojtja këshillohet]

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është faqja 895. Faqja që
9 përfundon me 895.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Sekretare, ju ndihmon kjo gjë?

13 Z. GILISSEN: [Përkthim]

14 PY. Z. Dëshmitar, a mund ta shihni vulën me ngjyrë blu dhe a
15 mund të na thoni çfarë thuhet në të? Që është blu e errët, pak
16 a shumë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila
18 vulë, për cilën vulë e keni fjalën?

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më duket në të majtë. Më duket se
20 në të majtë të faqes.

21 Faqja 30 e dokumentit, në të majtë, është vula në mes.
22 Është ajo vula që është në fund djathtas, që ka datën, vula që
23 ka datën 22 prill 1999.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull. Z. Dëshmitar, Avokati ju kërkoi që të shihni vulën që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 54

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 është në të majtë të faqes, në kahun e majtë të faqes. Faqja
2 30 është, dhe është vula që është në të djathtë. Vula e fundit
3 në të djathtë të anës së majtë të faqes, ajo me datën
4 22.4.1999.

5 Avokat, për këtë e kishit fjalën?

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, ajo që ka ngjyrën pak më blu
7 të errët.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Nuk ka
9 përkthim]

10 DËSHMITARI: Po.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim]

12 PY. Kjo vulë, çfarë thotë sipas jush? Një mbërritje apo
13 dalje? Çfarë është? Vulë hyrje apo vulë dalje, dhe në cilin
14 territor?

15 PË. Ajo është vulë dalëse nga Shqipëria, pikërisht nga
16 aeroporti i Rinasit.

17 PY. Këtë e shohim. Ka një vulë që tregon hyrje në Rinas. Apo
18 e kam unë gabim, është hyrje në Rinas kjo?

19 PË. Më lart, më 11 prill 1999, është kur kam hyrë nga
20 Durrësi. Është vula hyrëse më 11 prill. Ndërsa më 22 prill,
21 është vula dalëse nga aeroporti i Rinasit.

22 PY. Po. Ku është Rinasi, në cilin shtet?

23 PË. Është në Republikën e Shqipërisë, është aeroporti -- në
24 atë kohë ka qenë aeroporti i vetëm i Republikës së Shqipërisë.

25 PY. Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 55

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Tani shkojmë në faqen tjetër,
2 DPS00880-DPS00896.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
4 çaktivizuar]

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faqja 32 në dokumentin e shfaqur
6 në ekran, pasaportës. Do të doja të flisnim për vulën në mes
7 të faqes, por jo ajo e madhja, por ajo që është në krah me
8 ngjyrë blu. A mund ta zmadhojmë pak? Se nuk është shumë e
9 qartë kështu siç është tani.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Mikrofoni
11 çaktivizuar]

12 [Përkthim] Më falni, jo vula lart, por vula poshtë vulës
13 -- ajo që ka ato gjermanisht?

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, vula në krah. Jo Republika e
15 Austrisë, as e zeza, ajo që është blu në krah me të zezën.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ah,
17 në rregull.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] E kuptojmë. Është pak e vështirë.
19 Ka shumë vula.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Dëshmitar, ju kërkua të shihni vulën që është në mes të faqes,
22 në të djathtë, ngjitur me atë që është frëngjisht, dhe lart
23 shikohet AL. Për këtë vulë bëhet fjalë.

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

1 e ka fjalën Avokati.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. Z. Dëshmitar, a mund të na shpjegoni çfarë tregon kjo

4 vulë?

5 PË. Vula -- nuk e shoh bash mirë datën se -- është një vulë

6 dalëse nga Shqipëria, nga Republika e Shqipërisë.

7 PY. Po. Pra, po dilni këtu, tregon që keni dalë?

8 PË. Po.

9 PY. Qartë. Janë dy numra. I shihni dot, i lexoni dot datat?

10 PË. Nuk shihet bash pastër, nuk mund të jem i sigurt në ato

11 data por kësaj vule mund t'i bëhet ndonjë ekspertizë edhe të

12 përcaktohet saktësisht. Nuk e shoh datën e saktë. Por shoh

13 shkronjat që janë në muajin prill dhe nuk mund ta shoh datën e

14 saktë.

15 PY. Po vitin?

16 PË. Është viti 1999. Viti shihet.

17 PY. Faleminderit shumë. A mund të propozoj dhe të them që

18 është data 29 prill 1999?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ku

20 e shihni ju këtë?

21 Shoh që u çua dhe Prokurori.

22 Mbi ç'baza thoni që është kjo data?

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më duket sikur e pashë që kjo

24 është data.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 57

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 mund ta lejoj pyetjen atëherë. Dëshmitari mund të thotë "shoh"
2 ose "nuk shoh datën".

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] E di që është e vështirë
4 ndonjëherë, mbase pa syze, por unë po përpiqem të ndihmoj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
6 ta bëni ndryshe pyetjen, për të kuptuar ku ka qenë në atë
7 periudhë, sepse po hamendëson. Nuk ke bazë, as atij nuk i
8 kujtohet konkretisht.

9 Megjithatë, Avokat, që ta kemi të qartë për procesverbal
10 për cilën vulë bëhet fjalë, do i lutesha Asistentes ta
11 ndihmojë z. Dëshmitar t'i japë një laps ku të shënjojë vulën
12 për të cilën duhet të jepte përshkrimin. Dhe pastaj të marrë
13 numrin e provës materiale në Gjykatë. Shkojmë dhe tek faqja
14 pararendëse dhe të bëjmë të njëjtën gjë. Të marrim numrin e
15 provës materiale sepse do na ndihmojë në të ardhmen kur të
16 jetë nevoja që t'i referohemi të njëjtit dokument.

17 Z. Dëshmitar, atëherë rrethoni vulën për të cilën po
18 diskutoni me avokatin.

19 DËSHMITARI: [Shënon]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Sekretare, mund ta ruani, ju lutem, imazhin? A mund ta marrë
25 menjëherë numrin e provës materiale apo mund ta bëjmë më vonë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 58

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 I drejtohem Sekretares.

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
3 këshillohen]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
5 rregull, vazhdoni. Bëjmë të njëjtën gjë dhe për faqen që
6 mbaron me numër 895.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 shënimet që bëri dëshmitari DW4-06 do të marrin numrin
9 REG000964. Ju kërkoj ndjesë, edhe një herë numri i saktë është
10 REG00964.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit.

13 Avokat, do ta shohim dhe një herë faqen. Përpiqemi ta
14 zmadhojmë më shumë. Në qoftë se mund të dallojmë që --
15 Shkojmë në faqen 895 fillimisht.

16 Do ju luteshim z. Dëshmitar, edhe në këtë faqe, të
17 rrethoni vulën të cilën diskutuat më herët me Avokatin
18 Mbrojtës. Më saktë, të dyja vulat që u përmendën.

19 DËSHMITARI: Fillimisht po e rrethoj vulën hyrëse të 22
20 prillit, dhe vulën dalëse të --

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si
22 rregull -- fillimisht 11 prilli, ju keni hyrë në 11 prill. Ja
23 ta shoh dhe një herë.

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jeni

1 i sigurt?

2 DËSHMITARI: Dalja është. Nëse nuk gaboj, është dalja.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
4 një herë, kush është dalja? Dalja është 22 prilli apo dalja
5 është 11 prilli?

6 DËSHMITARI: Në bazë të shenjave, si e kuptoj unë, hyrja
7 është 22 prill, dhe në fund të prillit [E pakuptueshme] dalja.
8 Ndërsa këtu është hyrje tjetër në Durrës më 11 prill.

9 Nuk jam i sigurt te shigjetat, nuk jam i sigurt.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] As
11 unë, s'kam qenë atje. Është dëshmia juaj s'mund të them asgjë
12 në lidhje me këtë. S'mund të komentoj.

13 Patjetër.

14 DËSHMITARI: Atë që mund të them me siguri është se nga
15 fundi i muajit prill 1999, e deri në qershor të përfundimit të
16 luftës nuk kam qenë në Shqipëri. Këtë mund ta them me siguri
17 sepse kam qenë në Zvicër, në Francë, në Gjermani dhe në
18 Belgjikë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Avokat, keni sërish fjalën. Nëse doni të bëni ndonjë
22 sqarim të mëtejshëm keni mundësinë për ta bërë.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbase mund t'ju ndihmoj që ta
24 kuptojmë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 60

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 pastaj do t'i japim edhe numër prove materiale këtij
2 dokumenti.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares që tek i
4 njëjti dokument të shihnim faqen 23. Është një vulë tjetër --

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Avokat, nëse doni të kalojmë në një dokument tjetër?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, është i njëjti dokument.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
9 faqe tjetër. Fillimisht duhet të ruajmë këtë faqen, në mënyrë
10 që t'i japim një numër.

11 Sekretare, ju lutem ruani faqen dhe jepni numrin e provës
12 materiale.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet që bëri
14 dëshmitari DW4-06 do të marrin numër e Zyrës Administrative
15 REG00965.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Avokat, tani mund të kaloni në faqen tjetër.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

20 Dokumenti DPS00891. Është faqja 23 e pasaportës. Dhe doja
21 t'ia tregoja dëshmitarit.

22 PY. Dëshmitar, kjo është një vulë e Republikës Sllovene.

23 Është data 21 prill 1999. A ju kujtohet të keni bërë një

24 udhëtim që t'i përkojë kësaj date në këtë datë?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 61

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 PY. Ka lidhje kjo me atë vulën që pamë në faqen 30 të
2 pasaportës? Domethënë, ka lidhje me vulën e një dite më pas 22
3 prill 1999, në aeroportin e Rinasit, a lidhen këto dy vula me
4 njëra-tjetrën?

5 PË. Nëse mundem ta sqaroj. Për shkak të kontekstit të luftës,
6 edhe pse bileta ime ishte nga Cyrihu për në Tiranë, për shkaqe
7 të ndryshme të luftës, u detyruam të aterrojmë në Slloveni dhe
8 aeroplani nuk mundi të vazhdojë për në Tiranë. Për këtë arsye
9 më është dhënë viza hyrëse për një ditë, dhe të nesërmen kam
10 udhëtuar për në Tiranë.

11 Viza dyditëshe ka vetëm këtë sqarim.

12 PY. Nëse e kuptova saktë, ju mbërritët përmes Sllovenisë, pra
13 ju shkuat përmes Sllovenisë në Shqipëri? Ju kujtohet sa zgjati
14 ky udhëtim? Ky udhëtim konkret për të cilin po flasim.

15 PË. Udhëtimin konkret ju them ka zgjatë një ditë sepse unë
16 kam udhëtuar me Adria Airlines, kemi aterruar në Lubjanë, dhe
17 në pamundësi - NATO nuk lejonte fluturimet në ato intervale
18 kohore kur duhej të udhëtonim për në Tiranë - kemi qenë të
19 shtrënguar të arrijmë në Lubjanë dhe gjatë asaj kohe u kam ba
20 edhe vizita familjarëve që kam në Lubjanë dhe mbaj mend se ai
21 udhëtim ka zgjatë së paku 24 orë.

22 PY. Faleminderit. Mbërritët në Shqipëri, në Rinas. Çfarë
23 ndodhi pastaj? Sa ditë qëndruat apo javë, sa kohë qëndruat në
24 Shqipëri?

25 PË. Shkuarja ime në Shqipëri duhet të sqarohet. Ka qenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 62

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 shkuarje në cilësinë e anëtarit të kryesisë së Lëvizjes
2 Popullore të Kosovës. Gjatë gjithë periudhës së luftës, kam
3 pasë dy funksione. Kam qenë përfaqësues politik i Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës, dhe anëtar i kryesisë së Lëvizjes
5 Popullore të Kosovës.

6 Në Shqipëri --

7 PY. Ju lutem, vetëm datat, vetëm kohëzgjatja.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
9 te kohëzgjatja.

10 DËSHMITARI: Nuk besoj, po maksimumi një javë ditë e di që
11 në fund të muajit prill kam qenë në Zvicër.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Avokat, më fal që ju ndërpres. Për procesverbal, se duhet t'i
14 reflektojmë me procesverbal. Faqja 51, thuhet data 20, por
15 besoj se bëhet fjalë për 21 prillin. Pra data në vulë është
16 21, jo 20, apo jo? Është korigjuar. Ka qenë një lapsus, gabim
17 ortografik, vazhdoni.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim]

19 PY. Po përpiqem të bëj lidhjen mes vulës së datës 21 të
20 vendosur në Republikën e Sllovenisë dhe vulën e dytë që është
21 vendosur nga aeroporti i Rinasit. Dhe vula e tretë që shohim
22 në faqen 32 të pasaportës tregon që keni qenë në Kosovë dhe u
23 larguat përpara fundit të prillit të vitit 1999. A e kam
24 kuptuar siç duhet kronologjinë?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 63

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Kaluat në vend tjetër, në faqe tjetër. Pra ju po thoni faqja

2 32. Sekretare e Gjykatës a mund të shohim faqen 32?

3 Këtu, Avokat, në këto që shohim ne, ne nuk e kemi thënë

4 këtë gjë. Ky përfundimi që nxorët ju, është i pabazë. Unë do

5 dëgjoj çfarë thotë dëshmitari dhe ai mund ta thotë në dëshminë

6 e vet, por ju nuk mund të thoni këtë gjë bazuar në vulat në

7 faqen 32 se nuk e kemi vërtetuar, ne nuk e përcaktuar dot se

8 çfarë shohim në këtë vulë.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ashtu është, por s'kemi vula të

10 tjera në dokument.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

12 rregull, por kemi datën 21 prill në Slloveni, kemi përcaktuar

13 22 prillin, që është vulë hyrjeje nëse e kam kuptuar siç

14 duhet. Vulë hyrje në Shqipëri.

15 Pra, kemi hyrjen në Slloveni dhe të nesërmen hyrjen në

16 Shqipëri. Dhe të paktën në këtë pasaportë nuk ka ndonjë vulë

17 që të thotë se është larguar ai -- unë nuk po them që ai është

18 larguar, me siguri që ai është larguar. Por mos i bazoni

19 përfundimet tuaja mbështetur në këtë vulë.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, ka bërë një deklaratë, sapo

21 tha, "maksimumi një javë".

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

23 atëherë çfarë lidhje ka kjo me faqen 32? Se ju kërkuat që të

24 shfaqej faqja 32.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po pikërisht unë po përpiqesha ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 64

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 kuptoja. Se tha një javë, dhe kemi një vulë këtu dhe kjo i bie
2 që e vetmja vulë të jetë. Prandaj e bëra pyetjen unë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Atëherë më mirë bëni pyetjen dhe mos jepni përfundim.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Patjetër.

6 PY. Pra, ju u larguat nga Shqipëria në këto momente pas një
7 jave, pothuajse një jave?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Dëshmitar, prisni një çast. Përgjigju fillimisht pyetjes sime.

10 Ju thatë që qëndruat një javë ditë në Shqipëri, pak a
11 shumë, përafërsisht. Se ka kaluar shumë kohë e kuptojmë këtë
12 gjë. A ju kujtohet si u larguat nga vendi?

13 DËSHMITARI: Vulën që kam përpara, e ka tre germa të
14 mëdhaja APR, që nënkupton prillin, APRIL 1999. Kjo vulë dalëse
15 nga Shqipëria, nuk mund ta shoh datën e saktë, por është e
16 prillit të vitit 1999, vula dalëse nga Shqipëria.

17 Maksimum kam ndejtë një javë ditë në Shqipëri. Datën nuk
18 e di të sigurt, por di që në fund të prillit kam qenë në
19 Zvicër. Kjo është e sigurt.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit. E thatë edhe përpara pushimit këtë gjë, edhe e
22 mbajtëm shënim që je larguar nga Shqipëria. Faleminderit.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

25 keni ju fjalën, Mbrojtësi i Viktimave.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 65

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

2 Për procesverbal, më duhet të them kolegu im gabimisht tha

3 "Kosovë" në vend që të thoshte "Shqipëri" dhe mbase mund të na

4 krijojë probleme kjo gjë më pas. Kështu që, sa për sqarim.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Na e

6 thoni ku u përmend kjo?

7 Z. LAWS: [Përkthim] Në rreshtin 8. Faqja 53.

8 Kam përshtypjen që z. Gilissen tha "Kosovë", por e kishte

9 fjalën për "Shqipërinë".

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

11 në fakt e sqarua këtë.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, faleminderit. Se është pikë e

13 rëndësishme kjo.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do

15 sugjeroja dhe znj. Sekretare në qoftë se është e mundur të na

16 ndihmoni. A mund ta kthejmë këtë faqe nga ana tjetër dhe ta

17 sqarojmë më tepër në qoftë se është e mundur? Besoj se na e

18 lejon teknologjia, apo jo?

19 Avokat, e keni fjalën ju. Por tani në fakt pajtohem më

20 shumë se më përpara, e kam pak më të qartë, se shikoj një "A"

21 një "P" dhe një "R", është pak më e qartë besoj. Pra, është më

22 e thjeshtë të shikojmë këtë kullën, po i them unë, në të

23 majtë. Shikoj një numër. Mund të jetë 2 dhe 9, por nuk jam e

24 sigurt. Mund të jetë. Mund të jetë, por s'jam e sigurt.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Por ndoshta më mirë që të pyesim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 66

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 dëshmitarin.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
3 as dëshmitari nuk është ekspert për deshifrimin e këtyre
4 vulave të paqarta, besoj që jemi njësoj si ne, si dëshmitari.
5 Ajo që na ka ndihmuar të paktën deri tani, është që e zmadhuam
6 dhe mbase është një çikë më e qartë tani. Nuk dua që të
7 harxhojmë kohë për të marrë vesh se cili është numri, se numri
8 është ai që është. Edhe besoj që më dëgjuat qartë që thashë që
9 çfarë mund të jetë, por nuk e di me siguri. Megjithatë,
10 dëshmia e dëshmitarit është ajo që e ka përsëritur dy herë
11 deri tani, kështu që për momentin dua ta lëmë me kaq dhe nuk
12 dua ta shtjellojmë më tej.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Një pyetje të fundit, znj.
14 Kryetare.

15 PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet në qoftë se jeni larguar nga
16 territori shqiptar përpara fundit të prillit të 1999? Ju
17 kujtohet kjo gjë?

18 PË. Jam larguar në fund të prillit, atë e di. Për arsye se
19 është dashtë të jem në fillim të majit në Zvicër.

20 PY. Është shumë e qartë, shumë faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
22 do bëjmë një shënim.

23 Z. Dëshmitar, a mund të rrethoni vulën për të cilën kemi
24 diskutuar deri tani? Por jo këtë.

25 Zn. Sekretare e keni ruajtur këtë faqe? E kemi ruajtur,

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 67

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 mirë në rregull.

2 DËSHMITARI: A mundem ta rrethoj tani, apo?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,

4 faleminderit z. Dëshmitar.

5 Znj. Sekretare, a mund të thoni me zë -- jo po e them

6 unë.

7 Jemi në faqen 896 dhe po diskutojmë për vulën me ngjyrë
8 bojë qielli, me blu të lehtë. Besoj që kaq është e mjaftueshme
9 për të ditur se për çfarë po diskutojmë për ta bërë të qartë
10 për procesverbal.

11 Avokat, mund të vazhdoni.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Gjërat janë
13 komplekse, janë të vështira. E dimë. Tani dëshiroj t'ju tregoj
14 një tjetër dokument, dëshmitar. Me lejen tuaj e nderuar
15 Kryegjykatëse dua t'i tregoj dëshmitarit dokumentin që
16 shënohet me numrin ERN DPS00876-ET dhe dokumenti në shqip ka
17 numrin e identifikimit DPS00876. Është dokument i cili nuk
18 duhet të tregohet për publikun.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Avokat, me sa kuptoj unë, po i kërkoni Trupit Gjykues që të
21 paraqitet një tjetër dokument. A mund të na e jepni
22 shkurtimisht një shpjegim se çfarë qëllim ka ky dokument? Për
23 çfarë doni ta pyesni dëshmitarin në lidhje me këtë dokument?

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ne kemi marrë nga autoritetet
25 shqiptare disa dokumente që kanë të bëjnë me praninë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 68

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 dëshmitarit në territorin shqiptar. Ne kemi ca informacion që
2 na duhet që të marrim nga dëshmitari përmes përgjigjeve të tij
3 dhe se mund të ketë -- ca mospërputhje ndërmjet vulës në
4 pasaportë dhe dokumentit që kemi marrë nga autoritetet
5 shqiptare.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A nuk
7 është e mundur që të bëni pyetjen së pari, apo doni që,
8 mbështetur në atë çfarë keni diskutuar, dëshironi që të
9 tregoni këto dy dokumente një herë dhe pastaj t'i bëni pyetje
10 dëshmitarit?

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj se më mirë është që
12 dëshmitari të shikojë dokumentet dhe pastaj të bëhen pyetjet.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
14 kuptoj. Znj. Sekretare mund t'i paraqisni këto dokumente në
15 ekran, ju lutem.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Janë dokumentet që kanë në fund
17 *Revised*, të rishikuara.

18 Z. AOUBINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar
19 Gjykatës. Përkthimi në anglisht që kemi në ekran nuk është
20 versioni i rishikuar i përkthimit, që kërkoi z. Gilissen të
21 paraqitet. Është thujse i njëjti përkthim, megjithatë do të
22 donim që të përdornim versionin e përkthyer zyrtarisht të
23 këtij dokumenti.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
25 keni shtuar tek lista e provave materiale? E kam fjalën për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 69

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 këtë përkthimin e rishikuar.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Po, e kemi shtuar.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Më thonë që e bëmë kërkesën përmes
4 postës elektronike kur e kemi shtuar, por nuk e kemi shtuar në
5 radhën e prezantimeve e dokumenteve. Është thujse identik,
6 megjithatë thjesht donim që të paraqitej dokumenti i përkthyer
7 zyrtarisht.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
9 atëherë. Në këtë rast do flas me Sekretaren.

10 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Gjykatës

11 këshillohen]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
13 qoftë se tregojmë një çast durim, do ta shtojmë këtë dokument
14 në radhën e prezantimeve dhe do të mund ta përdorim prej aty.

15 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja e Gjykatës

16 këshillohen]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
18 shtuar në provat materiale.

19 Kështu që znj. Sekretare, do kërkoja që ta paraqisni në
20 ekran këtë dokument.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit.

22 PY. Z. Dëshmitar, kam të njëjtin dokument në duar. Dua t'ju
23 pyes fillimisht se për çfarë flet ky dokument, çfarë dokumenti
24 është ky?

25 PË. Unë ua kam sjellë këtë dokument që dëshmon se gjatë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 70

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 periudhës 15 prill 1999 deri më 26 maj 1999, nuk jam
2 regjistruar as për hyrje as për dalje në aeroportin e Rinasit.
3 Flitet për një kontekst historik kur ka qenë spastrimi etnik.
4 Kemi mund të mos regjistrohemi të gjithë njerëzit që kanë hyrë
5 apo që kanë dalë nga Shqipëria. Por nuk kanë mundur të hyjnë
6 apo të dalin pa pasë vulat. Pikërisht për këtë arsye, dhe me
7 qëllim që të jem sa më transparent para Gjykatës, ua kam
8 sjellë edhe dokumentin e udhëtimeve të asaj periudhe. Kam
9 kërkuar nga Zyra për Refugjatë në Zvicër ku e kam dorëzuar pas
20 duhet të korrigjoj pyetjet e mia. Ky është procesi.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Avokat, janë dhënë dëshmi për dy burime -- u dha dëshmi për dy
23 burime.

24 Do të doja të shkonit te pjesa tjetër e pyetjes. Ky
25 rekrutimi i pretenduar që ju thatë -- sepse kjo ishte një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 114

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 pjesë tjetër e rëndësishme e pyetjes tuaj. Ju lutem, vazhdoni.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. A keni ndonjë informacion lidhur me misionet që kryenin
4 këta persona që rekrutoheshin?

5 PË. Misioni është i qartë, sepse ish-Zëvendëskryeministri i
6 Jugosllavisë, Vuk Drashkoviç e bën të qartë se është dashtur
7 të vrasin serbë, shqiptarë dhe pjesëtarë të përkatësive të
8 tjera, dhe për këto krime t'i vishet përgjegjësia Ushtrisë
9 Çlirimtare të Kosovës. Përmasat e përfshirjes së kriminelëve
10 në kuadër të strukturave të shërbimit sekret, kanë qenë
11 marramendëse. Ua kam siguruar një burim gjithashtu serb,
12 Mbrojtjes, në të cilën flitet se me rastin e vrasjes së
13 Kryeministrit serb, Zoran Gjingjiq, janë arrestuar 8688
14 pjesëtarë të grupeve kriminale nëpër Serbi që kanë qenë në
15 lidhje të drejtpërdrejtë me shërbimin sekret serb.

16 PY. Në rregull. Faleminderit. Do të doja të fokusoheshim në
17 elementë që mund të kenë lidhje me çështje tonë gjyqësore, me
18 z. Shala. Unë desha të di nëse ju dini ndonjë rast kur
19 autoritetet gjyqësore serbe kanë vendosur që ka pasur fabrikim
20 provash apo nëse janë përdorur dëshmi të rreme në çështje
21 penale. Gjithmonë në lidhje me Kosovën, me UÇK-në, gjatë
22 luftës, jo në përgjithësi.

23 PË. Dy raste, dy procese gjyqësore dhe njëri prej tyre këtyre
24 dy proceseve gjyqësore lidhet edhe me procesin kundër Pjetër
25 Shalës. Prosesi i parë gjyqësor është për rastin Panda, në të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 115

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 cilën --

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Avokat, do të shoqërojmë një çast dëshmitarin jashtë sallës së
4 gjyqit dhe do të bëjmë një diskutim. Duhet të diskutojmë
5 diçka.

6 Dëshmitar, asistentja e sallës do t'ju shoqërojë jashtë
7 për një çast.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
10 shoh, po dëgjoj pyetjet tuaja -- jemi në faqen 99, rreshti 10,
11 e keni pyetur dëshmitarin nëse ka dijeni për ndonjë çështje
12 kur autoritetet gjyqësore serbe kanë vendosur se disa dëshmi
13 janë fabrikuar. Unë të paktën kuptova sikur ata kanë vendosur
14 që duheshin fabrikuar provat dhe vendosën se duhet të
15 krijoheshin dëshmi të rreme. Por pyetja -- ju po thoni këtu që
16 janë dy çështje, kur me sa duket autoritetet gjyqësore serbe,
17 të paktës sipas pyetjes tuaj, kanë krijuar, kanë shpikur
18 dëshmi.

19 Dhe kanë vendosur -- këtu thuhet kanë vendosur se disa
20 nga dëshmitë janë fabrikuar.

21 Nuk e kuptoj pyetjen. A mund ta riformuloni?

22 Pyetja tjetër, nëse dëshmitari di ndonjë -- ka dijeni për
23 dëshmi të rreme që janë përdorur në çështje penale. Unë besoj
24 se ua bëra të qartë që nuk do të lejojmë këtë linjë të
25 përgjithshme pyetjesh. Duam që pyetjet të lidhen me çështje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 116

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 gjyqësore të z. Shala. Kështu që nuk ta lejoj këtë pyetje,
2 sepse i dhashë dëshmitarit mundësin të përgjigjej dhe e
3 përfunduar duke dëgjuar një çështje për të cilën thamë që nuk
4 do të drejtojmë pyetje. Sepse nuk ja ke vërtetuar Trupit
5 Gjykues çfarë lidhje ka me çështjen gjyqësore të z. Shala. Nuk
6 e ke vërtetuar lidhjen, relevancën.

7 Po ua lë ju në dorë, po pyetjet në këtë mënyrë nuk do t'i
8 lejoj sepse edhe përgjigja e dëshmitarit nuk është e
9 nevojshme. Në qoftë se doni të bëni pyetje më konkrete,
10 shkojmë, kalojmë në seanca private e mund t'i bëni.

11 Z. Shala, do ta keni fjalën. Një çast, sa të kalojmë në
12 seancë private.

13 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur] Riklasifikuar në
14 bazë të F744
15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit, Sekretares.

18 Z. Shala. Këtu keni Avokatin Mbrojtës. Unë do t'ua jap
19 shumë shkurt fjalën. Çfarë doni të thoni z. Shala?

20 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit, po ju
21 nuk më lini Avokatin të bën pyetje, e nderuara Gjyqtare. Po
22 unë -- po të ishit ju nga Bangladeshi, do t'ju kisha kuptue.
23 Po ju jeni një qytetare evropiane dhe çfarë drejtësie bahet
24 fjalë. Çfarë drejtësie bëhet fjalë në qoftë se Mbrojtjes nuk i
25 lihet të bëjë pyetje, atëherë merrni udhëheqjen ju, bëni
pyetjet. Dhe le të shkojë në shtëpi Avokati, nuk ka nevojë me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Page 117

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 u pague. S'ka nevojë me u pague, bajini ju pyetjet. Unë po
2 pranoj që të dëgjoj pyetjet e juaja, se ju nuk e leni avokatin
3 të formulojë asnjë frazë, i ndërhyti. Ju faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Shala, ju faleminderit. Do t'ju them diçka që ta sqarojmë.
6 Pyetjet në sallën e gjyqit i lejon Trupi Gjykses vetëm në
7 qoftë se lidhen me çështjen gjyqësore. Nuk mund të diskutohet
8 çdo temë këtu në përgjithësi. Ne duam të shohim lidhjen me
9 çështje tuaj gjyqësore, rëndësinë që ka për çështjen tuaj
10 gjyqësore. Nuk do të diskutoj më tej. Do t'i drejtohem
11 Avokatit tuaj Mbrojtës.

12 Avokat, cila është pyetja e radhës që dëshironi të
13 drejtoni. Ose më saktë, çfarë parashtrimi do të bëni, apo
14 çfarë doni të thoni lidhur me atë që ju thashë?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Keni të drejtë. Nuk është se
16 donim të merrni informacion për ndonjëherë një raste konkret.
17 Rasti i kafenesë apo ndonjë gjë tjetër. Pyetja lidhet -- ne
18 duam të kuptojë përdorimin -- si janë përdorur disa persona të
19 dënuar, nëse ka ndonjë njohuri lidhur me përdorimin e dëshmimeve
20 të rreme ose mund të themi të fabrikuar. Mund të përdorim
21 sinonime. Po ne duam të kuptojmë çfarë di dëshmitari për këto,
22 dhe në bazë të njohurisë që di ai, që ka ai, të na thotë edhe
23 metodat të ngjashme që janë përdorur në çështje penale. Si
24 janë përdorur pra këto në çështjet që lidhen me luftën e
25 Kosovës. Dhe pastaj, hap pas hapi, nëse ka më shumë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 118

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 informacion, ose nëse ka ndonjë gjë për të thënë për çështjen
2 e z. Shala. Mbase edhe nuk ka.

3 Po unë duke i bërë pyetjen nëse -- unë mund ta pyesja
4 "Dini ju nëse është përdorur dëshmia e rreme në çështjen e z.
5 Shala". Për mua është shumë fjali e shkurtër që unë të marr
6 një përgjigje të njëmendtë. Të paktën unë kështu e kuptoj.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Prokuror, do ua jap fjalën.

9 Pra kjo është, Avokat, pikërisht kjo është. Për këtë
10 bëhet fjalë. E kam thënë disa herë, i gjithë qëllimi ky është.
11 Unë ju dhashë hapësirë të bëni pyetje që të merrni
12 informacione që mund të ketë ky dëshmitar lidhur me metodat që
13 kanë përdorur shërbimet sekrete serbe në raport, ose për
14 luftëtarët e UÇK-së. Unë përdora fjalët tuaja: "dëshmi të
15 rreme, dëshmi të fabrikuara".

16 E morëm përgjigjen për këtë, ishte shumë e qartë që në
17 pikëpamjen e tij kështu ka ndodhur, por ne po përpiqemi tani
18 të kuptojmë çfarë lidhje ka kjo me çështjen gjyqësore të z.
19 Shala. Dhe po përsëris edhe një herë veten, nuk dua t'ju
20 kufizoj pyetjet, por duam të gjejmë lidhjen me këtë çështje
21 gjyqësore.

22 Po ja jap fjalën edhe Prokurorit përpara se t'ua jap
23 sërish fjalën për t'u përgjigjur.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Ne i qëndrojmë
25 pozicionit tonë. Ne mendojmë që nuk ka asnjë relevancë çështja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 119

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 e lokalit Panda për çështjen tonë gjyqësore. Sidoqoftë,
2 dëshmitari bëri edhe lidhjen dhe e kemi në procesverbal:

3 " ...dhe mund të përmend dy çështje në çështjen penale:
4 Një që mund të lidhet me z. Pjetër Shala. E para është çështja
5 Panda."

6 Ne mendojmë prapë që nuk ka lidhje. I qëndrojmë kësaj,
7 megjithatë nuk na bën dëm ta dëgjojmë dëshmitarin, ku e sheh
8 ai lidhjen, meqenëse e tha. Ta kemi të qartë edhe në
9 procesverbal. Dhe sigurisht, duke -- nën udhëzimin tuaj për të
10 parë ku do shkojë, në mënyrë që të mos dalë nga -- të mos
11 humbasim qëllimin, kuptohet, por ne prapë themi, theksoj, nuk
12 ka asnjë relevancë për çështjen gjyqësore. Sidoqoftë, për ne
13 le ta përfundojë përgjigjen dëshmitari dhe ta dëgjojmë çfarë
14 ka për të thënë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
16 psherëtiva pak. Prapë them nuk është e qartë. Dëgjova edhe
17 pikëpamjen e ZPS-së. Prapë nuk është bërë e qartë nga Mbrojtja
18 se si këto çështje, këto -- mund të lidhen me çështjen e z.
19 Shala. Fjala është për ju.

20 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit. E vlerësojmë edhe
21 përgjigjen e kolegëve të Prokurorisë. Në faqen 99, rreshti 8,
22 z. Gilissen i bëri pyetjen konkrete për çështjen tonë. I tha:

23 "Faleminderit. tani do të fokusohem në disa gjëra që
24 mund të lidhen me çështjen tonë gjyqësore, çështjen gjyqësore
25 të z. Shala."

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Page 120

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Nuk është nevoja të citoj pjesën tjetër, po ai bëri një
2 pyetje të hapur, duke filluar me këtë, në këtë formë. I tha "A
3 ke ndonjë çështje që mund të thuash lidhur me manipulimin e
4 provave?". Edhe vetë dëshmitari tha çështja Panda. Gilissen
5 nuk i tha asgjë vetë lidhur me Pandën, është dëshmitari ai që
6 bëri këtë lidhje dhe ju na udhëzuar nëse ka ndonjë lidhje dhe
7 mund ta zbulojmë nga dëshmitari nëse ka lidhje. Duhet ta
8 dëgjojmë dëshmitarin dhe pastaj z. Gilissen ose do t'i bëjë
9 pyetje, ose do ta lërë fare në qoftë se shikon që nuk ka
10 relevancë.

11 Por ne dhamë kontekstin për të kuptuar lidhjen me
12 çështjen gjyqësore të z. Shala, kështu që ju lutem ta lejoni
13 këtë pyetje që është e hapur dhe të dëgjojmë çka për të thënë
14 dëshmitari.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Aouini, a mund t'i shpjegoni Trupit Gjykes se disa herë e kam
17 bërë pyetjen: Cila është lidhja në pikëpamjen tuaj. Çfarë
18 lidhje ka çështja Panda me çështjen e z. Shala.

19 Ju pyeta sot paradite. Nuk mora përgjigje dhe menjëherë
20 thatë "Jo, jo. Nuk do ta diskutojmë këtë gjë". E diskutova me
21 z. Gilissen, dhe z. Gilissen tha "Nuk do ta përfshijmë
22 çështjen Panda". Tani mua më krijohet përshtypja që ju jeni --
23 të paktën si e kuptoj unë, po shoh qëndrimin tuaj dhe po
24 dëgjoj çfarë po më thoni. Ne fillimisht nuk e gjetëm lidhjen.
25 Nga përgjigjet tuaja unë kuptova që ju nuk synonit ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 121

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 diskutonit çështjen Panda. E unë po ju pyes ju tani, se
2 dëshmitari juaj është. Ju e dini çfarë do të sjellë, çfarë do
3 të thotë ky dëshmitar për Mbrojtjen tuaj. Dhe unë po ju pyes
4 tani: A mund të na e shpjegoni çfarë lidhje, ku është lidhja
5 me këtë çështje gjyqësore?

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, konfirmoj në emër të z.
7 Gilissen që nuk synonim të eksploronim Pandën. Edhe pyetja nuk
8 kishte për synim të përfshinim çështjen Panda. Përpiqemi të
9 bëjmë lidhje mes fabrikimit të provave apo dëshmimeve edhe
10 inkurajimit të dëshmitarëve për t'u përfshirë në procese
11 penale dhe metodat. Këto metoda kanë ekzistuar që në kohën e
12 luftës, lidhur me UÇK-në, e deri sot e kësaj dite nga ana e
13 institucioneve.

14 Panda doli në përgjigjen e dëshmitarit, jo në pyetjen
15 tonë. Nëse i jepni pak mundësi z. Gilissen, unë ju them që ai
16 di shumë mirë sesi të mos lejojë humbjen e qëllimit, pra dhe e
17 them edhe një herë, ne nuk duam të diskutojmë Pandën, me
18 përjashtim të rastit ndonjëherë nëse dëshmitari ka një lidhje
19 konkrete. Duhet ta dëgjojmë prej tij. Por ne duam të bëjmë me
20 lidhjen me metodat që janë përdorur në proceset penale nga
21 institucionet, sesi kanë ndërhyrë në proceset gjyqësore të
22 lidhura më Kosovën, dhe me luftën për çlirim. Dhe ne duam të
23 vërtetojmë këtë lidhje.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
25 doni të vërtetoni një lidhje të përgjithshme? Pajtoheni me mua

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 122

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 që duhet ta lidhim me çështjen e z. Shala?

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Z. Gilissen do ta bëjë këtë përmes
3 pyetjeve.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Flisni me zë të lartë ju lutem.

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Z. Gilissen po përpiqet ta bëjë
7 këtë me pyetjet e veta.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mundet një çast?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Patjetër. Për mua është shumë e rëndësishme të kuptoj pyetjen
11 e radhës. Cila është pyetja e radhës që doni t'i bëni
12 dëshmitarit.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ajo që duam të bëjmë ne është që
14 pikësëpari, të dimë, të mësojmë nëse shërbimet sekrete serbe
15 vërtetë i kanë përdorur këto metoda. Nëse përgjigja është
16 "jo", atëherë e lemë me kaq. Është shumë e thjeshtë. Nëse
17 përgjigja mund të jetë e vërtetë, mund të mos jetë e vërtetë,
18 vendosni ju. Nëse përgjigja është "po", a mendon ai se ka edhe
19 informacion lidhur me përdorimin e disa metodave në çështjen -
20 në çështjet që lidhen me Kosovën, dhe pastaj pyetja ime e
21 radhës është konkretisht me çështjen Shala. Përgjigja mund të
22 jetë "po", mund të jetë "jo". Çështja Panda dhe të tjera, që
23 ju e dini për të cilën po flas, nuk janë të rëndësishme. Ne
24 duam të kuptojmë a kemi informacion të besueshëm për
25 përdorimin e këtyre metodave. Thotë "jo", e lemë me kaq. Thotë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Faqe 123

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 "po", e shtjellojmë më tej. A mund të jetë e rëndësishme dhe
2 për çështjen tonë? Le të përgjigjet dëshmitari për këtë. A ka
3 dijeni, po ose jo, për përdorimin e këtyre metodave, sesi janë
4 përdorur personat e dënuar, personat që kanë pasur probleme me
5 policinë, apo për metodat që po flisnim në çështjen e z.
6 Shala. Përgjigja mund të jetë "po" ose "jo". Pastaj a është i
7 besueshëm në përgjigjen e vet, diçka që duhet ta vendosni ju.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
9 nuk jemi -- nuk kemi arritur në këtë pikë. Ne po zbulojmë
10 informacion. Nëse flisni për metoda, është mirë që për
11 procesverbal ta pyesni dëshmitarin çfarë metodash. Se ju thoni
12 metoda. Nëse i referoheni -- do ju lejoj të vazhdoni me
13 pyetjet. Marr parasysh atë që tha edhe z. Prokuror, që
14 fillimisht ta pyesim për pikëpamjen sipas dëshmitarit, cila
15 është lidhja mes çështjes Panda dhe çështjes së z. Shala. Kjo
16 duhet të jetë pyetja e parë. Këtë duhet ta kemi sqaruar që në
17 fillim. Dhe pastaj vazhdoni me pyetjet tuaja.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, por unë nuk jam i interesuar
19 për çështjen Panda. Unë nuk jam i interesuar për çështjen
20 Panda.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Dakord, por ne tani duhet ta kuptojmë sepse dëshmitari tha që
23 ka parë lidhje, atëherë unë e kuptoj atë që thotë Prokurori
24 dhe pajtohem që duhet ta kemi -- duhet ta sqarojmë pse, ku e
25 shikon ai këtë lidhje. Dhe nëse nuk bëhet tani, do ta trajtojmë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F744

Page 124

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Prokuroria kur të bëjë pyetjet e veta.

2 Nëse nuk e bën as Prokuroria, do ta bëjmë ne si Trupi
3 Gjykues. Kështu që e përfundojmë këtë, e sqarojmë këtë.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë dua të kuptoj metodat. Së
5 pari, punësimin që folëm më herët; së dyti, ajo që sapo
6 diskutuam; dhe së treti, nëse dëshmitari mund të flasë për
7 përdorimin e këtyre metodave, edhe ky është -- çështje --
8 dëshmitari i tretë në një çështje penale, dhe sipas tij a janë
9 përdorur këto metoda nga shërbimet sekrete serbe në hetimin që
10 ka marrë Prokuroria. Ju e dini historinë, ju e dini, është një
11 proces delikat dhe i vështirë. Ju e dini shumë mirë që hetimi
12 është një gjë që zgjat shumë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
14 cila është pyetja, cila është baza, ku e bazoni njohurinë
15 tuaj? Këtë mund t'i bëni - këtë mund të bëni si pyetje: Ku e
16 bazoni njohurinë tuaj.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua të kuptoj përgjigjen, nuk
18 duam t'i bazojmë në thashetheme. Jemi në Gjykatë këtu. Ne do
19 të përpiqemi të shikojmë sa objektiv është informacion që jep.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Vazhdojmë. Jemi në seancë private. Sekretare?

22 Kalojmë në seancë publike, ju lutem.

23 ~~{Seancë e hapur}~~

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 jemi në seancë publike.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 125

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
2 Sekretare, silleni dëshmitarin në sallë, ju lutem.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
5 se erdhët, dëshmitar.

6 Përpara se sa t'i jap fjalën Avokatit për të vazhduar me
7 pyetjet, dëshiroj që t'i kthehem diçkaje që thatë më përpara.

8 Ju thatë se ka dy çështje, dy procese penale, dhe njëra
9 prej tyre ka të bëjë ose ka lidhje me çështjen kundër z. Shala
10 dhe ju thatë "Çështje e parë është çështja Panda".

11 Dëshiroj që të më thoni se çfarë lidhje ka çështja Panda
12 dhe çështje kundër z. Shala.

13 DËSHMITARI: Çështja që ka lidhje të -- procesin kundër
14 Pjetër Shalës është çështja e dytë. Çështja e Kleçkës, ku
15 Bashkim, Bekim Mazreku -- është çështje e dytë, jo çështje e
16 parë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
18 jo.

19 A e kuptoj drejtë që po thoni që çështja Panda nuk është
20 e lidhur me çështjen kundër z. Shala?

21 DËSHMITARI: Në mënyrë të nënkuptueshme, nxjerr në pah
22 sesi ka vepruar shërbimi seret serb, duke vrarë shqiptarë,
23 serbë dhe malazezë dhe duke marrë njerëz të pafajshëm për t'i
24 detyruar të pranojnë se gjoja ata kanë kryer krimet. Kjo është
25 mënyra e funksionimit të shërbimit dhe kjo ka lidhje të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 126

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 ndërthurur, të ndërmjetme me rastin e procesit të z. Shala.

2 Ndërsa rasti i Bekim Mazrekut ka lidhje me një person i cili
3 është drejtpërsëdrejti i implikuar.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
5 pjesë do ja lejoj Avokatit që ta shtjellojë më tej në qoftë se
6 dëshiron që të bëjë pyetje të tjera ,se pyetja ime kishte të
7 bënte vetëm thjeshtë për lidhjen midis çështjes Panda dhe
8 çështjes kundër z. Shala. Ndërkohë që sa i takon pyetjeve të
9 tjera, do ja lë fjalën z. Gilissen për të vazhduar më tej.

10 Kur të jeni gati për të vazhduar, mund të vazhdoni z.
11 Gilissen.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit.

13 PY. Z. Dëshmitar, e kuptoj që sipas jush, lidhja midis
14 çështjes për të cilën jemi këtu dhe çështjes për të cilën po
15 mendoni, ka të bëjë me metodat e përdorura nga shërbimet
16 sekrete të Shqipërisë. A e kam gabim, e kam kuptuar drejtë apo
17 kam gabuar gabim [sipas përkthimit].

18 PË. Dëshët të thoshit të Serbisë, jo të Shqipërisë?

19 PY. Po, ju kërktoj ndjesë, për këtë po flasim.

20 PË. Në rastin Panda, është pikërisht funksionimi i shërbimit
21 sekret në këtë drejtim. Ndërsa në rastin Mazreku, është një
22 njeri i cili është i përfshirë në këtë rast, i cili ka pasur
23 kontakte me Prokurorinë Speciale dhe ka dhënë një kontribut në
24 Prokurorinë Speciale. Prandaj rasti i dytë është i ndërlidhur
25 drejtpërsëdrejti me rastin e z. Shala.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 127

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Avokat, duhet që të korrigjojmë diçka në transkriptim.

3 Përgjigja nuk u dha nga Kryegjykatësja por u dha nga

4 dëshmitari.

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, sigurisht.

6 PY. Atëherë, ta marrim hap pas hapi. Nëse e kuptoj drejtë dhe

7 në qoftë se nuk e kam kuptuar drejtë, ju lutem më ndërprisni

8 dhe më korrigjoni, por nëse ju kuptova drejtë ju mendoni se

9 keni informacion të besueshëm sa i takon përdorimit të

10 personave që ishin të ndaluar, të dënuar, pra që këta persona

11 ishin përdorur nga shërbimet sekrete të sigurimit serb, dhe që

12 janë përdorur madje edhe për fabrikimin e disa provave në

13 çështje penale të lidhur me shqiptarë nga Kosova gjatë

14 periudhës 1998-99. Kështu?

15 PË. Në procesin Panda kemi mbi 100 persona që torturohen

16 mizorisht dhe 6 persona të rinj detyrohen të nënshkruajnë

17 pohimin, deklaratat pohuese se gjoja kanë vrarë gjashtë serbë

18 dhe malazezë në kafenenë Panda dhe kanë vrarë shumë policë në

19 fshatin Carabreg dhe në fshatin Prilet të komunës së Deçanit.

20 Kanë pasur dy akuza të bëra nën tortura të tmerrshme. Mbas

21 dhjetë muajsh hetime, në procesin gjyqësor që mbahet në

22 Levkovc, kur Gjykata pyet "Për çfarë arsye keni nënshkruar

23 deklaratata se keni kryer krimin, nëse ju mohoni krimin?". Ata

24 nxjerrin këmishët ku shihen prerjet me thikë, dhe djegie me

25 zjarr të trupave, at të tmerrshme kanë qenë plagët sa Gjykata

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 128

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 e ndërpret procesin gjyqësor. Ka qenë në muajin e tetor të
2 vitit --

3 PY. A mund t'ju ndërpres.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit Avokat, por herë tjetër dua që të ndërhyjni më
6 herët se ndonjëherë nuk po kërkojmë këtë.

7 Z. GILISSEN: [Përkthim]

8 PY. Ne nuk kemi këtë qëndrim dhe nuk mendojmë që kjo është e
9 vlefshme për çështjen e z. Shala. Folëm lidhur me
10 metodologjinë ose për metodat, kështu që dëshirojmë që të dimë
11 në qoftë se autoritetet serbe kanë njohur përdorimin e
12 dëshmitarëve të rremë apo dëshmitarëve të cilët kanë dhënë
13 dëshmitë e tyre të pasakta, lidhur me ngjarje të caktuara.

14 PË. Pikërisht në këtë rast, sikurse edhe në rastin tjetër, në
15 rastin e Bekim Mazrekut, i cili ka qenë torturuar për të
16 deklaruar publikisht gazetarit për çështje ushtarake - është
17 Dreçun -- Dreçunit i ka dhanë. Milovan Drecunit, merr
18 intervistë.

19 PY. Z. Dëshmitar ju kërkoj ndjesë që po ju ndërpres. Por nuk
20 është një -- pyetja nuk ka të bëjë me torturimin ose
21 dëshmitarët e rremë. Pyetja është kjo: A keni informacion
22 lidhur me përdorimin e dëshmitarëve ose të ashtuquajturve
23 dëshmitarë, të cilët kanë bërë qëllimisht deklarata të rreme?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

25 çështjen Shala, që kanë lidhje me çështjen Shala. Pra, nuk do

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 129

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 insistoj sepse e dini këndvështrimin e Trupit Gjykses, por
2 duhet që pyetja të ketë lidhje me çështjen kundër Shalës.
3 Eventualisht duhet të ketë në lidhje.

4 DËSHMITARI: Nëse më lejoni të sqaroj, do shoh -- do të
5 nxjerr në shesh lidhjen që ka ky proces me procesin Shala. Ju
6 lutem më lejoni të shpjegoj se është e rëndësishme. Kush është
7 Milovan Dreçun? Ai gazetari i cili tenton të marrë dëshmi të
8 rrejshme nga një i ri i arrestuar. Pas asaj ai dënohet.
9 Dënohet dhe pas dënimit, dënohet me 20 vjet, së bashku me
10 vëllain e vet, edhe pse dëshmohet që ai ka qenë i arrestuar
11 një muaj, 27 ditë para se të ndodhte ngjarja në Kleçkë. Pas
12 rënies së Milosheviçit, lirohet nga akuza edhe kthehet në
13 Kosovë. Milovan Dreçun ka qenë gazetar ndaj të cilit Shoqata e
14 Pavarur e Gazetarëve të Serbisë ka ngrit padi penale kundër
15 Milovan Dreçunit për nxitje të krimeve në Kosovë. Pikërisht ky
16 Milan -- Milovan Dreçun ka dhënë intervistë televizive më 28
17 shtator të vitit 2020, në të cilën pohon se ka pasur kontakte
18 me Prokurorinë e Specializuar. Ai i nënçmon prokurorët, thotë
19 "Nuk kanë ditur çka të bëjnë, si të orientohen. Unë i kam
20 orientu në drejtimin sesi duhet të bëhen hetimet, ua kam tregu
21 se në -- pej UÇK-së ka pasur 159 qendra ndalimi, 6 prej të
22 cilave kanë qenë në Shqipëri". Edhe thotë "Jam i lumtur që i
23 kam ndihmuar Prokurorisë Speciale që të kualifikohet Ushtria
24 Çlirimtare e Kosovës si ndërmarrje e përbashkët kriminale".
25 Qendrat e ndalimit janë produkt i propagandës serbe dhe kjo ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 130

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 lidhje të drejtpërsëdrejti me procesin e Pjetër Shalës.

2 PY. A mendoni që keni ndonjë element që ta lidhni këtë metodë
3 të Prokurorisë ose hetimet të cilat janë përdorur në këtë
4 tribunal në këtë çështje gjyqësore, pra në çështjen kundër
5 Shalës?

6 PË. Unë nuk e di se cilat metoda janë përdorur, por në
7 pohimet që thotë Milo --

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Dëshmitar, a mund të flisni pak më ngadalë në mënyrë të tillë
10 që të përktheheni plotësisht nga përkthyesit?

11 DËSHMITARI: Nuk e di saktësisht sesi janë zhvilluar
12 proceset gjyqësore sepse jam i angazhuar në përgatitjen e një
13 vepre që mendoj ta botoj më 15 janar, në ditën e gjenocidit
14 prandaj nuk i pak përcjellë.

15 Por atë që e di, se Milovan Dreçun pohon se të gjitha
16 dosjet ja ka dhënë Prokurorisë dhe e ka orientuar Prokurorinë
17 në çfarë drejtimi duhet t'i udhëheqë udhëtimet, dhe për këtë
18 kontribut, ka marrë mirënjohjet me dorëshkrim. E thotë
19 tekstualisht.

20 Nuk e kam përfunduar, a mund ta vazhdoj?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 [Mikrofoni çaktivizuar] ...Avokati, është dëshmitari juaj.

23 Z. GILISSEN: [Përkthim]

24 PY. Dua që të më jepni një përgjigje të plotë, në qoftë se
25 sigurisht ka lidhje me pyetjen.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 131

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fakti
2 qo ju do të botoni një libër nuk është me rëndësi, kështu që
3 ju lutem përgjigjuni pyetjes që do t'ju bëjë avokati.

4 DËSHMITARI: Të vazhdoj në përgjigjen, konkretisht
5 dëshmitarët janë siguruar nga ekipi i udhëhequr - se ai është
6 udhëheqësi i ekipit që ka bashkëpunuar me Prokurorinë
7 Speciale, që është udhëhequr nga një njeri të cilin gazetarët
8 e pavarur të Serbisë e akuzojnë si përgjegjës për krime, janë
9 dëshmitarë të rrejshëm sepse ai është i gatshëm të sajojë një
10 mijë e njëqind gënjeshtër për të arsyetuar qëllimin e vet. Të
11 njëjtën gjë e ka bërë edhe gjetiu në Kroaci, të njëjtën gjë e ka
12 bërë edhe në Kosovë.

13 Nuk është duke u përkthyer, nuk dëgjoj.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim]

15 PY. A mund të na e përsërisni edhe një herë emrin se e kishte
16 të fikur mikrofonin Gilissen dhe ndonjëherë nuk e dëgjuam.

17 PË. Milovan Dreçun. Është një njeri i tillë, i cili ka
18 udhëhequr grupin që i ka ofruar dëshmitë dhe dëshmitarët
19 Prokurorisë Speciale, i cili nëse do të realizojë qëllimin e
20 vet, jam i bindur se do të sjellë dëshmitarë për të gjithë
21 këtë trupin tuaj, e prokurorëve dhe --

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
23 rregull.

24 DËSHMITARI: -- kanë kryer krime në Kosovë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 132

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 mund të pyesni lidhur me bazën e njohurive të dëshmitarit,

2 mund t'ia bëni këtë pyetje, z. Gilissen, dëshmitarit tuaj?

3 Z. GILISSEN: [Përkthim]

4 PY. Po. Duam të dimë se cila është baza e njohurive tuaja për

5 të gjitha faktet që sapo përmendët?

6 PË. Është një --

7 PY. A mund të na thoni burimet e informacionit, cilat janë

8 burimet tuaja?

9 PË. Burimi i këtij informacion është intervista televizive ku

10 ai flet tekstualisht këto fjalë që i them, pa i shtu asgjë, pa

11 i interpretuar, kur thotë tekstualisht se ka orientuar

12 Prokurorinë në çfarë drejtimi duhej t'i zhvillojë hetimet.

13 Është një njeri që vjen nga një palë ndërluftuese, i cili

14 merret nga Prokuroria si njeri që sjell prova për të dëshmuar

15 se UÇK-ja është ndërmarrje kriminale. Për këtë është provë,

16 sepse Prokuroria nuk reagoi asnjëherë përballë kësaj dëshmie,

17 të hedhë poshtë. Përkundrazi, ai thotë që ka marrë mirënjohje.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

19 rregull. Avokat, ne dëshirojmë që të kemi një dëshmitar që jep

20 dëshmi mbështetur në njohuritë e veta sa i takon çështjes

21 kundër z. Shala. Shpresoj që e kuptoni këtë, kështu që pasi

22 dëgjova burimin, është diçka që është transmetuar, por nuk

23 është kjo mënyra se si të prezantohen këto lloj provash

24 materiale. Shpresoj që të pajtoheni me mua lidhur me këtë

25 pikë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 133

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua që të sigurohem që ky
2 informacion që ka të bëjë me juridiksionin e DHSK-së, dhe në
3 veçanti të z. Shala, çështjen kundër z. Shala. Ky person a ka
4 folur lidhur me çështjen për të cilën jemi këtu, me çështjen
5 që po trajtojmë këtu në Hagë, çështjen kundër z. Shala.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë
7 se më lejoni.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
9 vazhdoni.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kemi dëgjuat tani, pra
11 dëshmitari ka thënë për intervista të individit -- nuk e di në
12 qoftë se Mbrojtja ka në zotërim këtë intervistë, por gjithsesi
13 duam që të dimë ndonjë lloj treguesi se për çfarë interviste
14 bëhet fjalë. Domethënë, kur është transmetuar, ku është
15 transmetuar, në çfarë date, në mënyrë të tillë që të ndjekim
16 atë çfarë po thotë dëshmitari me saktësi. Duam pak më shumë
17 informacion për intervistën që përmend dëshmitari.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Avokat, varet nga ju në qoftë se doni t'ia bëni këtë pyetje
20 dëshmitarit, megjithatë dua që të përsëris edhe një herë
21 udhëzimet tona që ne na intereson që të kemi dëshmi nga
22 dëshmitari që kanë të bëjnë me njohurinë e vet lidhur me
23 çështjen e z. Shala. Sepse në qoftë se jo, i takon që --
24 mendoj që do të duhet që të thërrasim dëshmitarë të tjerë, që
25 të na thonë se çfarë dinë sipas njohurive të tyre. Përveç

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 134

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 pyetjes që tha ZPS-ja, pra që të vini në dispozicion më shumë
2 informacion lidhur me këtë burim -- besoj se e keni të qartë
3 se çfarë pyeta -- çfarë thashë.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj që do jetë pyetja ime e
5 fundit, sepse mendoj që ne e diskutuam sa i takon qëllimit të
6 të burgosurve dhe ne dëshirojmë që Trupi Gjykses të thërrasë
7 një dëshmitar, por ky dëshmitar kur ne e kemi kërkuar ka
8 refuzuar që të vijë. Megjithatë, kam këtë pyetje për z.
9 Mahmuti.

10 PY. Z. Dëshmitar, a ke ndonjë element që lidhet midis këtyre
11 metodave që ju përmendët dhe çështjes kundër z. Shala?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
13 kërkoj ndjesë, Avokat, por nuk është e qartë për mua pyetja.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Do të përpiqem ta riformuloj.

15 PY. A keni elementë që mund të shtoni sa i takon lidhjes
16 reale, pra një lidhje të drejtpërdrejtë midis metodës që ju
17 përshkruat, që përdorej nga shërbimet sekrete në periudhën që
18 folëm pak më herët, për vitet 1998-99, dhe çështjes së z.
19 Shala?

20 A keni elementë të tjerë që mund të na i jepni në mënyrë
21 të tillë që mund t'i trajtojmë, mund t'i shtjellojmë?

22 PË. Çështjen e videoincizimit mund t'ua siguroj. Sapo të
23 përfundoj, mund t'ua siguroj, që mund të shihet. Është 16
24 minuta e disa sekonda. Domethënë, si burim ku flet. Çështjen e
25 ndërlihdhjes është shumë e qartë me procesin për mendimin tim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 135

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 sepse Dreçun me këtë intervistë tregon që nuk ka ditë
2 Prokuroria dhe burimi i qendrave të ndalimin, për 6 qendrat e
3 ndalimit në Shqipëri, i është dhënë nga Dreçuni. Është një
4 ndërlidhje shumë e qartë ndërmjet asaj se kush i ka sajuar
5 qendrat e ndalimit dhe procesit kur ndër të tjera z. Shala
6 akuzohet për diçka të ngjashme. Ndërlidhja është e këtillë,
7 për mua është e qartë sepse ai thotë që i ka njoftu, se
8 Prokuroria nuk ka ditë. Bile tekstualisht do ta dëgjoni ai
9 thotë lutallitcu" [fonetiksiht], përdor një fjalë serbe që
10 është tepër nënçmuese për Prokurorinë që thotë se s'kanë ditë,
11 janë end pa kurrfarë qëllimi, dhe ky i ka mësu sesi duhet të
12 veprohet ndaj shqiptarëve.

13 Do -- videon unë mund t'ua siguroj sapo të dalim prej
14 këtuhit.

15 PY. Faleminderit. E di që ndonjëherë është e dhimbshme dhe
16 mënyrën -- mënyra që ne përdorim në këtë gjykatë mbase mund të
17 jetë e vështirë sepse kemi mënyrën tonë të funksionuarit.
18 Megjithatë nuk kam pyetje të tjera.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
21 një pyetje për t'ju kuptuar më mirë, z. Dëshmitar. Folët për 6
22 qendra ndalimi. Njëra prej këtyre qendrave të ndalimit -- ose
23 ta bëj ndryshe pyetjen a i njihni se si e kanë pasur emrat
24 këto qendrat e ndalimit që i përmendët? A e dini se për cilat
25 qendra ndalimi bëhet fjalë, këto të gjashta?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 136

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 DËSHMITARI: Në intervistën e Milovan Dreçunit thuhet në
2 mënyrë të përgjithësuar që nga 195 qendrat ndalimi, 6 kanë
3 qenë në Shqipëri --

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Pyetja ime është kjo: A i dini emrat e qendrave të ndalimit?
6 Këtë pyetje kam, dhe përgjigja juaj ishte që ato janë
7 përmendur në përgjithësi në intervistë. Domethënë përgjigja
8 jua është që "Jo nuk i dini se për çfarë qendrash ndalimi e ka
9 fjalën ai". Kështu? është e drejtë kjo? Këtë thatë? Që nuk e
10 dini se për çfarë qendrash ndalimi -

11 DËSHMITARI: Nuk përmenden --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Në qoftë se ju thoni që ka një lidhje të drejtpërdrejtë,
15 një lidhje reale me çështjen e akuzave kundër z. Shala, pra me
16 fjalë të tjera ju nuk e dini në qoftë e ky person i referohet
17 çështjes së z. Shala, ose një nga qendrave që ka të bëjë me
18 çështjen kundër z. Shala.

19 DËSHMITARI: Nëse më lejoni të shpjegoj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
21 jo. Thjesht dua të di në qoftë se -- nëse keni dëgjuar në këtë
22 intervistë që të përmendet vendi që është përmendur në
23 aktakuzën kundër zë Shala, që përmban akuzat e ngritura kundër
24 z. Shala.

25 DËSHMITARI: Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bardhyl Mahmuti (Seancë e hapur)

Faqe 137

Pyetje nga z. Gilissen

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ora
2 është 15.30.

3 z. Prokuror, si mendoni? Si parapëlqeni më tepër, të
4 filloni sot, apo të filloni nesër në mëngjes.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, na duhet
6 akoma që t'i përgjigjemi kundërshtimit të Mbrojtjes për
7 përdorimin e dokumenteve tona, kështu që do na duhet ca kohë
8 mbase që të shikojmë dokumentin, sepse sikurse e thashë e
9 morëm këtë email, e morëm postën elektronike vetëm ndërkohë që
10 po futeshim në sallën e gjyqit. Dhe ndërkohë që do të
11 përgatitemi për të dhënë përgjigje, në qoftë se do na jepni
12 leje, jemi gati që të fillojmë nesër. Do të ishte më mirë për
13 e që të fillojmë nesër në mëngjes.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
15 në rregull. Atë çfarë do të bëjmë është që, ju lutem ,na
16 dërgoni parashtrimet tuaja lidhur me kundërpërgjigjet tuaja
17 për parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me dokumentet që dëshironi
18 që të përdorni nesër në marrjen në pyetje të dëshmitarit prej
19 jush, maksimumi deri në orën 17.00 ose më herët në qoftë se
20 mundeni.

21 Do të fillojmë nesër me ju, me pyetjet tuaja, pra të
22 Prokurorisë.

23 Pastaj do të bëjë pyetje Mbrojtësi i Viktimave dhe Trupi
24 Gjykes mund të ketë pyetje gjithashtu për dëshmitarin.

25 Atëherë do të fillojmë nesër përsëri në orën 09.00.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 138

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 Z. Dëshmitar, shumë faleminderit që ishit me ne sot dhe
2 të faleminderit për dëshminë e dhënë sot. Ju kujtoj që nuk
3 duhet të diskutoni me askënd për dëshminë e dhënë përpara
4 Trupit Gjykues sot. Do të shihemi përsëri nesër në mëngjes në
5 orën 09.00. Faleminderit që ishit me ne sot.

6 DËSHMITARI: [E padëgjueshme]

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit, zonja Sekretare.

10 Përpara sesa të vijojmë më tej, a ka ndonjë gjë që
11 dëshiron të ngrejë Prokuroria me Trupin Gjykues?

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Mbrojtësi i Viktimave, z. Laws?

15 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Mbrojtja, dëshironi të ngrini diçka me neve?

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Vetëm diçka kam, e nderuar.

19 Juristët, avokatët janë persona të çuditshëm dhe z. Shala nuk
20 është një prej nesh. Kështu që besoj që keni mundësi, të
21 nderuar Gjykatës, të kuptoni që ndonjëherë z. Shala ka
22 ndjesinë që gjërat nuk po shkojnë në mënyrën e duhur, dhe mund
23 të keq keqkuptime [sipas përkthimit] të caktuara. Më duhet të
24 pranoj që në procedurat penale ndërkombëtare edhe unë e kam të
25 vështirë të kuptoj situata, kështu që jam i sigurt që e

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F744.

1 kuptoni se ndonjëherë z. Shala po vlon në momente të caktuara.
2 Nuk është njeri i keq fare, ose kjo nuk do të thotë që ka
3 mungesë respekti për procesin dhe për të gjithë ju. Thjesht
4 doja t'ua bëja me dije këtë gjë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
6 marrim parasysh Avokat, dhe duhet të jeni i sigurt që Trupi
7 Gjykues i merr parasysh këto komentet tuaja.

8 Në rregull, atëherë. Faleminderit përkthyesve,
9 stenografes, ishte ditë e ngjeshur. Faleminderit gjithashtu
10 edhe personelit të sigurisë dhe personelit audioviziv. Do të
11 takohemi përsëri nesër në mëngjes.

12 Këtu mbyllet seanca.

13 --- Seanca mbyllet në orën 15.32

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25